

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXIV, nr. 7902
E mërkurë, 9 tetor 2024
Çmimi 0.50

PSD-ja nuk garon në zgjedhjet e 9 shkurtit

FAQE 5




Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

AKTUALE



NOBELI PËR FIZIKË U JEPET DY SHKENCËTARËVE QË ZHVILLUAN INTELIGJENCËN ARTIFICIALE F. 2

OSMANI: KOSOVA VAZHDON TË JETË E PËRKUSHTUAR PËR BASHKËPUNIM RAJONAL F. 5

AAK-ja KËRKON VEPRIME TË MENJËHERSHME PËR UJIN E PASIGURT TË BADOVCIT F. 6

BASTISJET NË MMPHI, DY TË DYSHUAR PËR VEPRA TË NDRYSHME PENALE F. 3

EKONOMI



KURTI NË MBLEDHJEN E KËSHILLIT KOMBËTAR PËR EKONOMI DHE INVESTIME: TË FOKUSOHEMI MË SHUMË NË MUNDËSITË E INVESTIMEVE F. 3

PJESËMARRJA E KOSOVËS NË "EXPO 2025" DHE INVESTIMET JAPONEZE F. 8

SPORT



HADARI, PAS PEJËS, I THOTË LAMTUMIRË EDHE KOSOVËS F. 10

KOMUNAT BËJNË THIRRJE QË URGJENTISHT TË ZGJIDHET PROBLEMI I KONTRATAVE KOLEKTIVE, HUMBËN 115 MILIONË EURO

FAQE 4-5



Kryetari i Asociacionit të Komunave të Kosovës, Agim Aliu, në takim me kryeministrin Albin Kurti dhe ministrat, ku ishin të pranishëm edhe kryetarët e komunave, ka thënë se deri më tani komunave të Kosovës nga arka e buxhetit komunal u janë marrë afro

115 milionë euro si pasojë e obligimeve financiare ndër vite për kontratën kolektive, gjersa vetëm në dy vitet e fundit mbi 80 milionë euro është shuma financiare e paguar nga komunat për obligimet e kontratave kolektive. "Qeveria e Kosovës duhet në mënyrë të

menjëherhme të ndaj buxhet shtesë për komunat, në proporcion me shpenzimet e kontratave kolektive si dhe të nisn procedurat ligjore e buxhetore, për rimbursimin e obligimeve të paguara deri më tani nga komunat", ka thënë Aliu

MAQEDONCI E PRANON SE KANË VËSHTIRËSI NË FURNIZIMIN ME USHQIM PËR PJESËTARËT E FSK-së F. 7



HARADINAJ AKUZON KURTIN: POPULLIT I SHET PROPAGANDË, SERBISË I BËN KONCESIONE F. 3



RENOVA
Maqedoni PUTZ
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
E-mail: renova@mt.net.mk
Mobi: +377 44 501 289

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë.
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Nobeli për Fizikë u jepet dy shkencëtarëve që zhvilluan inteligjencën artificiale

NJU-JORK, 8 TETOR - Geoffrey Hinton, i njohur si babai i inteligjencës artificiale, dhe fizikani John Hopfield, e kanë fituar Çmimin Nobel për Fizikë, për punën e tyre në vendosjen e themeleve për inteligjencën artificiale.


Hulumtimet e tyre në vitet '80 e kanë shtruar rrugën për teknologjinë që mund të bëjë revolucion në shoqëri, ndonëse sa shkon e shton shqetësime apokaliptike.

“Në situatë të njëjtë do ta bëja sërish të njëjtën gjë, mirëpo shqetësohem se pasoja e përgjithshme është që sistemet mund të jenë më inteligjente sesa ne, dhe që mund të marrin kontrollin”, ka thënë britaniko-kanadezi Hinton, 76-vjeçar, në një bashkëbisedim me gazetarët, pasi i është dhënë çmimi. Hinton ka çuditur të gjithë më 2023

kur ka dhënë dorëheqje nga puna e tij në gjigantin Google, duke paralajmëruar për “treziqet e mëdha për shoqërinë dhe njerëzimin” që vijnë nga teknologjia.

Ellen Moons, udhëheqëse e Komitetit të Nobelit për Fizikë, ka thënë në një konferencë për medie se pajisjet teknologjike janë bërë pjesë e jetës sonë, përfshirë identifikimin e fytyrës së njeriut dhe mundësinë e përkthimit të gjuhëve. Ndonëse e ka duartrokur potencialin e inteligjencës artificiale, Moons ka thënë se “zhvillimi i saj i shpejtë ka rritur shqetësimet edhe për të ardhmen tonë kolektive”.

“Njerëzit e bartin përgjegjësinë për përdorim të kësaj teknologjie të re në mënyrë të sigurt dhe etike”, ka thënë ajo.



Hopfield, 91-vjeçar, profesor amerikan në Universitetin Princeton, është përmendur si

personi që ka krijuar “rrjetin Hopfield”, i njohur si memorie kompjuterike, që mund të përdoret

për të “ruajtur edhe rikrijuar imazhe dhe gjëra të tjera” përmes të dhënave që ka në dispozicion.

OBSH-ja paralajmëron për rrezik të sëmundjeve në Liban

BEJRUT, 8 TETOR - Një zyrtar i Organizatës Botërore të Shëndetësisë (OBSH) ka paralajmëruar të martën se ka rrezik për shpërthimin e sëmundjeve në Liban për shkak të kushteve në strehimoret e mbipopulluara dhe njerëzve të zhvendosur dhe mbylljes së spitaleve, pasi mjekët janë duke ikur nga sulmet izraelite.

Ushtria izraelite i ka nisur operacionet tokësore edhe në jugperëndim të Libanit të martën, duke e përshkallëzuar konfliktin njëvjeçar me grupin e mbështetur nga Irani, Hezbollah, si pasojë e të



cilit janë vrarë mbi 1 000 njerëz në dy javët e fundit. “Ne po përballemi me një gjendje kur

rreziku për shpërthimin e sëmundjeve është shumë më i lartë si, për shembull, diarreja,

hepatiti A dhe një numër sëmundjesh të parandalueshme përmes vaksinimit”, tha në një konferencë për media Ian Clarke, zyrtar i OBSH-së në Liban.

Agjencia shëndetësore e Kombeve të Bashkuara ka paralajmëruar tashmë se sistemi shëndetësor është i mbingarkuar dhe deri tani pesë spitale në vend janë mbyllur dhe katër të tjera funksionojnë vetëm pjesërisht, tha Clarke.

Ai shtoi se spitale të mbyllur sepse mjekët ose janë larguar për shkak të luftimeve, ose u është kërkuar të evakohen nga autoritetet libaneze.

Në të njëjtën konferencë, një zyrtar i Programit Botëror për Ushqim (WFP) shprehu shqetësim për aftësinë e Libanit për ta ushqyer veten, duke thënë se mijëra hektarë tokë bujqësore në jug të vendit janë djegur ose braktisur për shkak të përshkallëzimit të luftimeve. “Sa i përket bujqësisë dhe prodhimit të ushqimit, ka një shqetësim të jashtëzakonshëm për aftësinë e Libanit për të vazhduar të ushqejë veten”, tha Matthew Hollingworth, drejtor i WFP në Liban, duke shtuar se të korrat nuk do të ndodhin dhe prodhimet po kalben në fusha.

Kim Jong Un kërcënon me përdorimin e armëve bërthamore kundër ShBA-së dhe Koresë së Jugut

PHENIAN, 8 TETOR - Lideri i Koresë së Veriut, Kim Jong Un, ka paralajmëruar përsëri se mund t'i përdorë armët bërthamore në konflikte të mundshme me Korenë e Jugut dhe me Shtetet e Bashkuara, raportuan mediet shtetërore të martën. Ai i akuzoi këto dy vende se po e provokojnë Korenë e Veriut dhe se po i rrisin armiqësitë në Gadishullin Korean.

Kimi ka bërë disa herë kërcënime të ngjashme për përdorimin e armëve bërthamore për parandalimin e sulmeve kundër vendit të tij, por paralajmërimi më i ri vjen në një kohë kur ekspertët e jashtëm thonë se Koreja e Veriut mund t'i rrisë armiqësitë para zgjedhjeve presidenciale në ShBA muajin e ardhshëm.

Gjatë një fjalimi të hënën në një universitet që mban emrin e tij, Universiteti i Mbrojtjes Kombëtare Kim Jong Un, ai tha se Koreja e Veriut “do t'i përdorë pa asnjë ngurrim të gjitha armët sulmuese kundër armiqve të vet”, nëse ata përpiqen t'i përdorin forcat e armatosura kundër Koresë së Veriut, sipas agjencisë zyrtare të lajmeve të Veriut, KCNA. “Në këtë rast, nuk përjashtohet as mundësia për përdorimin e armëve bërthamore”, shtoi ai.

Kimi tha se qëndrimi bërthamor i Koresë së Veriut duhet të përmirësohet plotësisht, sepse Koreja e Jugut dhe Shtetet e Bashkuara po përpiqen ta forcojnë aleancën e tyre ushtarake bazuar në planifikimin e përbashkët bërthamor dhe



strategjik, një veprim që ai tha se do të rrisë rrezikun e prishjes së ekuilibrit të pushtetit në Gadishullin Korean.

Duket se ai iu referua udhëzimeve të reja mes Koresë së Jugut dhe ShBA-së për

parandalimin e sulmeve, që këto dy vende i nënshkruan në korrik, për t'i integruar armët konvencionale të Koresë së Jugut me armët bërthamore të ShBA-së, për t'u përballur më mirë me kërcënimet e vazhdueshme që

vijnë nga Koreja e Veriut. Koreja e Jugut nuk ka armë bërthamore.

Prej se e miratoi një doktrinë agresive bërthamore në vitin 2022, Koreja e Veriut është zotuar në mënyrë të përsëritur se do t'i përdorë armët bërthamore e para, nëse parashikon se udhëheqësia e Penianit është e rrezikuar.

Por, shumë ekspertë dyshojnë nëse Koreja e Veriut mund ta bëjë vërtet këtë, pasi forcat e saj ushtarake janë më të dobëta se ato të ShBA-së dhe Koresë së Jugut.

Zyrtarët e ShBA-së dhe të Koresë së Jugut kanë paralajmëruar se një përpjekje e Koresë së Veriut për të përdorur armë bërthamore do të kishte për pasojë fundin e qeverisë së Kimi.

Haradinaj akuzon Kurtin: Popullit i shet propagandë, Serbisë i bën koncesione

PRISHTINË, 8 TETOR - Kryetari i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Ramush Haradinaj, ka reaguar pas vendimit të qeverisë për lejimin e mallrave të Serbisë. Haradinaj e ka akuzuar kryeministrin Albin Kurti se po bën koncesione në dëm të Kosovës. Sipas tij, nëpërmjet vendimit për hapjen e pikës kufitare në Merdar për mallrat e Serbisë, "tentoi ta mbulojë me 20 euro për pensionistët".

"Dje në mënyrë klandestine kryeministri Kurti hoqi masat ndaj mallrave të Serbisë. Kjo ishte përsëritje e vendimit për heqjen e tarifës 100 për qind që pata vendosur më 2018. Ky është koncesioni i radhës i Albin Kurtit, i cili popullit i shet propagandë e Serbisë i bën koncesione. Ai bën koncesione pasi paraprakisht i bën dëme të rënda Kosovës e pas koncesionit dëmi i mbetet Kosovës. Ai bëri koncesione të

vonshme edhe për anëtarësim në Këshill të Evropës, por Kosova mori vetëm dëmin, por jo anëtarësimin. Koncesionin e djeshëm tentoi ta mbulojë me 20 euro lëmoshë për pensionistët, por si shoqëri e kemi obligim ta ballafaqojmë me propagandën e tij dhe dëmet që po i bën Kosovës. E thënë edhe më herët, Kurti nuk i shërben Kosovës", ka shkruar Haradinaj në "Facebook".



Kurti në mbledhjen e Këshillit Kombëtar për Ekonomi dhe Investime: Të fokusohemi më shumë në mundësitë e investimeve

EPOKA
ERE

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 8 TETOR - Kryeministri Albin Kurti mori pjesë në mbledhjen e Këshillit Kombëtar për Ekonomi dhe Investime, ku u diskutua rreth çështjeve kyçe që lidhen me prioritetet ekonomike dhe reformat për zhvillimin e progresin e mëtejshëm të vendit. Ai trajtoi disa nga hapat që Qeveria e Kosovës po ndërmerret për ta përmirësuar klimën e biznesit dhe për t'i nxitur investimet e huaja si dhe zhvillimin e brendshëm.

Kryeministri Kurti potencoi se Kosova është një destinacion tërheqës dhe i favorshëm për investime dhe se me një popullsi të re dhe dinamike, vendi ynë ka potencial të madh për t'u shndërruar në një qendër rajonale për investime dhe transfer të proceseve të biznesit. Më tej, listoi disa nga faktorët të cilët e mbështesin këtë potencial e që përfshijnë: stabilitetin institucional të vendit tonë, që është i shoqëruar me fuqizimin e demokracisë dhe sundimin e ligjit; afërsia me tregjet e Evropës Perëndimore, që ofron mundësi për tregti dhe investime; rritja ekonomike mesatare prej 6.2 % gjatë këtyre dy viteve të fundit, e cila tregon një trend pozitiv në zhvillimin ekonomik; zhvillimi i projekteve infrastrukturore në



sektorët e transportit, mjedisit dhe energjisë, të cilat janë thelbësore për një ekonomi të qëndrueshme; zhvillimi i hovshëm i grupeve sektoriale si shërbimet e mundësuar nga teknologjia informative, prodhimi, bujqësia dhe

përpunimi i ushqimit të cilët janë motorë të rritjes ekonomike; dhe rinia e madhe, e cila, e kombinuar me ekspertizën, shumëgjuhësinë e saj edhe vullnetin e mirë të mërgatës sonë, përbëjnë një element të rëndësishëm për zhvillimin e vendit.

Kryeministri foli edhe rreth fuqisë sonë punëtore dhe rëndësinë e përmirësimit të arsimit dhe trajnimit profesional në përputhje edhe me nevojat e sektorit privat. "Tash që po flasim janë 23 shkolla në 14 komuna anembanë Kosovës, me 12

profile, gjithsej rreth 1 600 nxënës dhe jemi qeveria e parë në Kosovën e pasluftës, ku nuk ka pasur asnjë protestë të vetme në të cilën figuron parulla: 'Duam punë'. Duam paga më të larta, sigurisht, kushte më të dinjitetshme të punës, padyshim, por 'duam punë' nuk ka më parulla dhe kjo besoj që është pasojë e drejtpërdrejtë e 75 mijë vendeve të reja të punës në 425 mijë nga 350 mijë sa ishin në pranverën e vitit 2021", u shpreh Kurti.

Ai shtoi se konkurrenca fer nga sektori privat në njërin anë dhe përmirësimet e duhura dhe me kohë nga institucionet publike në anën tjetër, janë çelësi për përmirësimin e vazhdueshëm të mjedisit të të bërit biznes dhe të nxitjes së zhvillimit të mëtejshëm ekonomik.

Në përmbyllje të fjalës së tij, kryeministri kërkoi që dialogu i sotëm të fokusohet gjithnjë e më shumë në mundësitë e investimeve dhe të eksportit dhe se përmes politikave të mira ne mund t'i parandalojmë sfidat, sepse mund t'i parashikojmë ato dhe të sigurojmë rritje të qëndrueshme. "Që të vazhdojmë këtë dialog, unë besoj se duhet ta konfirmojmë qëllimin e qartë, e ky është: ta bëjmë Kosovën një vend ku bizneset lulëzojnë dhe qytetarët jetojnë mirë, gjithnjë e më mirë." përfundoi kryeministri.

Bastisjet në MMPHI, dy të dyshuar për vepra të ndryshme penale

PRISHTINË, 8 TETOR - Policia e Kosovës, respektivisht Njësi i Krimeve Ekonomike, ka zbarkuar sot në objektin e Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, ku me urdhër të Prokurorisë Speciale ka kryer bastisje.

Lidhur me këtë rast nga Prokuroria Speciale kanë bërë me dije për "Telegraf"-in se janë dy persona të dyshuar për kryerjen e veprës penale

që lidhen me keqpërdorim të detyrës zyrtare, shpëlarje parash dhe mosraportim apo raportim të rremë të pasurisë, të të ardhurave, të dhuratave, të dobisë a detyrimeve financiare. "Lidhur me rastin për të cilin keni pyetur, ju informoj se me urdhër të Prokurorisë Speciale të Kosovës është duke u zhvilluar një aksion në MMPHI. Janë dy persona të dyshuar për kryerjen e

veprës penale që lidhen me keqpërdorimin e detyrës zyrtare nga neni 414 i KPK-së, shpëlarjes së pasurisë nga neni 302 i KPK-së dhe veprës penale të mosraportimit apo raportimit të rremë i pasurisë, të të ardhurave, të dhuratave, të dobisë tjetër materiale ose detyrimeve financiare, nga neni 430, paragrafi 2 i KPK-së", kanë deklaruar nga Prokuroria Speciale.





Komunat bëjnë thirrje që urgjentisht të zgjidhet problemi i kontratave kolektive, humbën 115 milionë euro

Kryetari i Asociacionit të Komunave të Kosovës, Agim Aliu, në takim me kryeministrin Albin Kurti dhe ministrat, ku ishin të pranishëm edhe kryetarët e komunave, ka thënë se deri më tani komunave të Kosovës nga arka e buxhetit komunal u janë marrë afro 115 milionë euro si pasojë e obligimeve financiare ndër vite për kontratat kolektive, gjersa vetëm në dy vitet e fundit mbi 80 milionë euro është shuma financiare e paguar nga komunat për obligimet e kontratave kolektive. “Qeveria e Kosovës duhet në mënyrë të menjëhershme të ndaj buxhet shtesë për komunat, në proporcion me shpenzimet e kontratave kolektive si dhe të nisn procedurat ligjore e buxhetore, për rimbursimin e obligimeve të paguara deri më tani komunat”, ka thënë Aliu

financat e pushtetit lokal. Pikërisht, në këtë mes, qëndron sfida e pakapërcyeshme financiare e komunave të Kosovës”, është shprehur Aliu.

Ai ka thënë se janë dhjetëra shkresa, takime zyrtare, konferenca ndërinstitucionale e kumtime të tyre publike, ku i janë adresuar edhe pranë nivelit qeveritar, edhe pranë organeve të drejtësisë, këtë shqetësim, që ka mbërthyer financën e pushtetit lokal në çdo komunë të Kosovës. “Të cenohet buxheti edhe ashtu i pamjaftueshëm i komunave është një barrë e papërbalueshme, me komplikime të shumanshme e dëme të pariparueshme për komunat e Kosovës, andaj sot e deri në zgjidhjen e kësaj çështje problemore, që shkon përtej përkatësisë partiake, etnike, komunat njëzëri kërkojnë nga ju z. kryeministër, nga Qeveria e Republikës së Kosovës - zgjidhjen e drejtë, meritorë për obligimet financiare të kontratave kolektive”, është shprehur ai.

Aliu i është drejtuar kryeministrit dhe ministrave që të ndahet buxhet shtesë për komunat. “Qeveria e Republikës së Kosovës duhet në mënyrë të menjëhershme të ndaj buxhet

shtesë për komunat, në proporcion me shpenzimet e kontratave kolektive si dhe të nisn procedurat ligjore e buxhetore, për rimbursimin e obligimeve të paguara deri më tani nga komunat, që për buxhetet komunale paraqesin shifra shumë milionëshe. Komunat ndër vite kanë miliona euro më pak, për t’i investuar në projekte e nisma me dobi për qytetarët. Komunat ndër vite kanë shtrëngesa financiare, pasiguri për të nisur e zhvilluar projekte nga bllokada e pakapërcyeshme e obligimeve të Kontratës Kolektive. Kjo gjë duhet të marrë fund, z. kryeministër! Qytetarët presin që kontributi i tyre të kthehet në investim me dobi publike e jo në pasiguri të qeverisjes. Deri më tani komunave të Kosovës nga arka e buxhetit komunal u janë marrë afro 115 milionë euro si pasojë e obligimeve financiare ndër vite për kontratat kolektive, gjersa vetëm në dy vitet e fundit mbi 80 milionë euro është shuma financiare e paguar nga komunat për obligimet e kontratave kolektive”, ka thënë ai.

Agim Aliu, i cili është edhe kryetar i komunës së Ferizajt, ka thënë se janë miliona euro mungesë në

arkat e komunave. “Qindra projekte të porealizuara anembanë Kosovës ndër vite. Qindra projekte të rrezikuara cilësisht si pasojë e tkurrjes së detyrueshme financiare e pasigurisë buxhetore nga procedurat përmbartimore. Është kjo pasqyra financiare sot e komunave të Kosovës. Është ky jostabiliteti buxhetor, që zvetënon autorizimet e autoritetin e institucioneve lokale”, ka theksuar Aliu.

Ai në këtë takim ka paraqitur tri kërkesa: “Andaj, sa më sipër, Asociacioni i Komunave të Kosovës kërkon që: 1. Qeveria e Republikës së Kosovës, pasi që është nënshkruese e kontratave kolektive përmes ministrave me sindikatat përkatëse, të parashih mbulimin e plotë buxhetor të shpenzimeve që burojnë nga kontratat kolektive në buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2025 dhe për vitet vijuese përmes Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve; 2. Qeveria e Republikës së Kosovës, të rimbursojë mjetet e shpenzuara deri më tani nga komunat për obligimet financiare që rrjedhin nga kontratat kolektive; 3. Të mos lejohet bllokimi i xhirrolgarive të

EPOKA
ERE

Mal QORRAJ

Prishtinë, 8 tetor - Kryetari i Asociacionit të Komunave të Kosovës, Agim Aliu, ka thënë se vetëm përmes kontratave kolektive humbjet e komunave llogariten të jenë rreth 115 milionë euro.

Në takim me kryeministrin Albin Kurti, ministrat dhe kryetarët e komunave, Aliu ka theksuar se

komunat e Kosovës tash e sa vite po sfidohen në çdo ditë të punës së tyre me jostabilitet financiar, pamjaftueshmëri buxhetore, pengesa dhe bllokada sistematike, që kanë një burim, kanë një adresë, ka një emërues të përbashkët - obligimet financiare që rrjedhin nga Kontrata Kolektive. “Siç dihet mirëfilli, Kontrata Kolektive është një akt ligjor i ndërmarrë nga qeveria qendrore, gjersa burimin e financimit e mbështet padrejtësisht në

Osmani: Kosova vazhdon të jetë e përkushtuar për bashkëpunim rajonal

Prishtinë, 8 tetor - Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, ka falënderuar homologët e Malit të Zi, Kroacisë dhe Sllovenisë për pritjen në kuadër të samitit të liderëve të Procesit të Bërdo-Brione

në Tivat. Osmani ka thënë se Kosova vazhdon të jetë e përkushtuar për bashkëpunim rajonal. "Falënderoj presidentët Milatović, Pirc-Musar dhe Milanović për mirëseardhjen

e tyre në takimin e liderëve të procesit Bërdo-Brione në Tivat, ku patëm mundësinë ta diskutojmë vizionin tonë për të ardhmen e rajonit. Kosova vazhdon të jetë e përkushtuar për

bashkëpunim rajonal, të bazuar në fqinjësi të mirë, gjithëpërfshirje dhe qëllimin e përbashkët për integrim në institucionet euroatlantike", ka shkruar Osmani në "Facebook".



Maqedonci e pranon se kanë vështirësi në furnizimin me ushqim për pjesëtarët e FSK-së

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

Prishtinë, 8 tetor - Në mbledhjen e Komisionit për Çështje të Sigurisë dhe Mbrojtjes, të kryesuar nga kryetari Bekë Berisha, që u mbajt të martën, ka raportuar ministri i FSK-së, Ejup Maqedonci.

Në fillim të mbledhjes kryetari Berisha u shprehu ngushëllime familjarëve të tre të rinjve të cilët humbën jetën në një aksident te Liqeni i Badovcit, duke kërkuar njëkohësisht nga ministri i Punëve të Brendshme dhe Policia të sigurojnë sinjalistika, ndriçim dhe patrullim, në mënyrë që të mos përsëriten aksidente të tilla.

Tutje, diskutimi i anëtarëve të Komisionit me ministrin e FSK-së ka vazhduar për dy çështje kryesore: shërbimi dhe furnizimi me ushqim i pjesëtarëve të FSK-së dhe



largimi i pjesëtarëve të FSK-së. Ministri Maqedonci fillimisht prezantoi në detaje aktivitetet e ministrisë dhe FSK-së, operacionet, ligjet, rregulloret, zhvillimin e kapaciteteve ushtarake, vizitat, trajnimet etj., ndërsa më pas dha përgjigje në shqetësimet që u ngritën në

Komision. Ai tha se janë në përfundim të zgjidhjes së çështjes së ushqimit dhe se fokusi i tyre është ndërtimi i një koncepti të ri më afatgjatë, që do të garantojë ushqim për FSK-në.

Ai pranoi se janë në një situatë të vështirë gjatë kësaj periudhe për

shkak të kontratës dhe tranzicionit të shërbimit me ushqim me kapacitete vetjake, duke shfrytëzuar furnizimin përmes autoritetit qendror të prokurimit.

Ndërsa sa i përket çështjes së largimeve të pjesëtarëve të FSK-së, ministri Maqedonci sqaroi se

gjatë vitit 2024 FSK-ja është lënë nga 119 pjesëtarë që, sipas tij, i bie rreth 3 për qind nga numri total. Ai tha se çdo largim është i dhimbshëm, megjithatë shtoi se vazhdon të ketë interesim të jashtëzakonshëm të të rinjve për t'iu bashkangjitur FSK-së.

Edhe përfaqësues të tjerë të FSK-së vlerësuan se arsyetimi i largimit të pjesëtarëve të FSK-së lidhet me migrimin e bashkimitin familjar.

Tutje, në Komision u shtruan çështje të ndryshme nga anëtarët. Përpos largimit të ushtarëve të FSK-së dhe ushqimit, çështje tjetër që u ngrit ishte edhe ajo e uniformave dhe blerja e armatimit. Ndërkaq, disa nga anëtarë të Komisionit vlerësuan se largimin nga FSK-ja nuk e shohin si shqetësues meqë, sipas tyre, 77 pjesëtarë janë larguar në bazë të ligjit për shkak të pensionimit. Pastaj mbledhja e Komisionit ka vazhduar me dyer të mbyllura.

PSD-ja nuk garon në zgjedhjet e 9 shkurtit



PRISHTINË, 8 TETOR - Kryetari i Partisë Socialdemokrate, Dardan Molliqaj, ka bërë me dije se më 6 tetor partia që drejton ka mbajtur mbledhjen e rregullt të Këshillit Drejtues. Ai ka thënë se midis diskutimeve të situatës politike, kanë vendosur edhe për hapat e ardhshëm të veprimit politik, duke mos marrë pjesë në zgjedhjet parlamentare të 9 shkurtit.

Molliqaj ka thënë se do të jenë në ambientin politik e elektoral që e pret Kosovën. "Kësaj here jo përmes kandidaturës, por përmes aksionit dhe fjalës. Qartazi, alternatives politike që përfaqëson PSD-ja, nuk e ka mbështetjen e duhur për përfaqësim në Kuvend. Kështu, kemi vendosur ta refuzojmë rrugën e dobët të koalicionëve ku bindjet do të na lakoheshin, por edhe fatin që na e paracakton probabiliteti që

gjithsesi është brenda popullizmit të këtij momenti. Kosova rrezikohet prej popullizmit me prirje autoritare të partisë në pushtet. Por përgjigja për këtë regjim politik e diskursiv nuk është 'djali i mirë' e 'normal' me higjienën e fjalorit politikisht korrekt. Ky opsion, nën petkun e racionalitetit, edhe në Kosovë si gjithkund tjetër, përfaqëson pushtetet e kaluara ku ligjin e bënte kapitalizmi grabitqar. Në vend të votës, duam të japim shembull aktivizmi. Shpresa që duam të ndërtojmë është kalitja që ta sjellë veprimi yt, dhe jo faktorët nga jashtë. Fluska e aktivitetit opozitar duhet të bëhet mësim. Kështu do të ndërtohet një trajektore tjetër, me notat e momentet e veta, edhe përtej edhe përkundër kohës e hapësirës së këtij pushteti", ka thënë Molliqaj.

komunave për arsye të përmbartimeve si rrjedhojë e obligimeve të kontratave kolektive. Duke qenë në lartësinë e përfaqësimit të interesit të qytetarëve, ne të zgjedhurit e tyre, kemi detyrimin që të synojmë përparimin për mirëqenien e qytetarëve, mos t'ia mohojmë investimet në dobi të tyre, të

garantojmë stabilitetin financiar të komunave, të synojmë projekte që i japin dimensione të reja zhvillimi komunave tona, andaj presim nga Qeveria e Republikës së Kosovës, nga ju z. Kryeministër, të mirëkuptoni kërkesat tona, shqetësimet e brengat tona të sigjerta, duke vënë në tryezën tuaj të punës, këto shqetësime, për t'i

dhënë zgjidhje përfundimtare - sfidave financiare të Komunave të Kosovës", ka thënë Aliu para anëtarëve të qeverisë. Ndërkaq kryeministri Albin Kurti tha se gjatë qeverisjes së tij, Bruto Produkti Vendor është rritur me 33 për qind, ndërkaq buxheti i shtetit 35 për qind.

Kryeministri u kërkoi kryetarëve të

komunave rritjen e numrit të nxënësve, profileve dhe shkollave. Ai kërkoi që "punët e mbara t'i vazhdojmë", ndërsa tha se qeveria do t'u ndihmojë komunave. "Ju inkurajoj të gjithëve që e keni tashmë mësimin dual, ta rrisim bashkërisht numrin e nxënësve, numrin e profileve, numrin e shkollave, ndërkaq ju të nderuar

kryetarë e nënkryetarë të komunave që nuk e keni ende sistemin e arsimin dual, është mirë që sa më parë të fillojmë një bashkëbisedim që ai të vendoset edhe aty ku ende nuk është. Ne jemi këtu për t'ju ndihmuar e për t'ju përkrahur, andaj edhe për këtë le ta intensifikojmë dialogun e bashkëpunimin", ka thënë Kurti.

Vdes babai i Haxhi Shalës, nipi i tij thotë se vdiq me mall që ta shihte edhe një herë djalin

PRISHTINË, 8 TETOR - Ka ndërruar jetë Xheladin Shala, babai i ish-prororit të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Haxhi Shala. Lajmin për vdekjen e tij e kanë dhënë familjarët e tij, ndërsa djali i Haxhi Shalës ka bërë një postim në "Facebook", duke shkruar se ai ka vdekur me mallin që ta shihte djalin e tij. "Sot, në orët e para të mëngjesit, na la gjyshi

jonë i dashur, Xheladin Shala. U largove me mallin që ta shohësh edhe një herë djalin tënd, një mall që nuk munde ta shuaje dot. Zemra ime është e rënduar nga kjo dhimbje, sepse ti dëshiroje aq shumë të ishe sërish me të. E megjithatë, u prehsh në paqe, gjyshi im! Në kujtimet tona, ti do të jetosh gjithmonë, me atë dashuri të

pafund që na dhe forcën që gjithmonë na jepje", ka shkruar ai. Tutje, nipi i tij, Flakron Shala, thotë se "mungesa jote do të ndihet gjithnjë, por ne do ta mbajmë kujtimin tënd të gjallë". Haxhi Shala po vazhdon të mbahet në paraburgim në Hagë nga Gjykata Speciale.



AAK-ja kërkon veprime të menjëhershme për ujin e pasigurt të Badovcit

PRISHTINË, 8 TETOR - Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) ka shprehur shqetësim të thellë lidhur me cilësinë e ujit nga Liqeni i Badovcit.

Sipas raportimeve nga KRU Prishtina dhe IKShPK-ja, uji nuk është i sigurt për konsum për shkak të përqendrimeve të larta të manganit, një problem që po përsëritet.

Partia opozitare thekson se ekspozimi afatgjatë ndaj niveleve të larta të manganit mund të shkaktojë dëmtime neurologjike dhe zhvillimore të trurit, veçanërisht te fëmijët. "Kjo situatë përbën një rrezik të madh për shëndetin publik dhe kërkon veprime të menjëhershme", thuhet në reagimin e AAK-së.

AAK-ja, po ashtu, kritikon ashpër



mungesën e veprimeve konkrete nga ana e KRU Prishtina dhe Qeverisë së Kosovës për ta parandaluar përsëritjen e këtij problemi.

AAK-ja ngre pyetje të rëndësishme lidhur me përgjegjësinë institucionale, duke kërkuar llogari nga KRU Prishtina, Qeveria e Kosovës dhe Autoriteti Rregullator për Shërbimet e Ujit (ARRU).

Partia opozitare kërkon investime të menjëhershme në teknologji të reja për përmirësimin e trajtimit të ujit dhe planifikim afatgjatë për të shmangur kriza të ngjashme në të ardhmen. "Disa pyetje që kërkojnë përgjigje janë: Pse KRU Prishtina nuk ka ndërmarrë masa për përmirësimin e

trajtitimit të ujit, kur ky problem është i njohur dhe përsëritet çdo vit? Cili ka qenë roli i Qeverisë së Kosovës, e cila vazhdimisht ka trumbetuar se tani ndërmarrjet publike menaxhohen nga borde dhe menaxhmente profesionale? Cili ka qenë roli i ARRU-së, si autoritet rregullator dhe i pavarur, për të parandaluar dhe mos lejuar përsëritjen e këtij problemi? Institucionet

përkatese duhet të ndërmarrin veprime të menjëhershme, përfshirë investime në teknologji të reja për përmirësimin e trajtimit të ujit, monitorim të vazhdueshëm të cilësisë dhe planifikim afatgjatë për të shmangur kriza të ngjashme në të ardhmen", thuhet në reagimin e AAK-së.

Minatorëve iu del vetëm gjysma e rrogave, reagon sindikata



PRISHTINË, 8 TETOR - Sindikata e Pavarur e Minatorëve të "Trepçës" ka deklaruar se janë zhgënjyer edhe një herë, pasi të martën u është kompensuar vetëm 51 për qind e pagës. Në një reagim në "Facebook" thuhet se ata janë në pritje të pagave të plota sot dhe menaxhmenti duhet t'i kryejë detyrat e tyre. "Deri kur do të vazhdoj një ofendim i tillë ndaj minatorëve dhe cili është qëllimi i vërtet i këtyre vendimeve të kundërligjshme?! Për muaj me radhë, që nga zgjedhja e menaxhmentit të ri në ndërmarrje kemi heshtur dhe

toleruar, lloj-lloj vendime dhe qasje që është i kundërligjshëm dhe në kundërshtim me interesat e minatorëve, me qëllimin e vetëm dhënia e hapësirës së mjaftueshme menaxhmentit të ri për të dëshmuar veten. Shpresojmë që menaxhmenti i ndërmarrjes shqetësimin tonë ta marr me seriozitetin më të lartë, duke bërë menjëherë ekzekutimin e plot të pagave. Ashtu që loja me bukën e minatorëve duhet të marr fund një herë e përgjithmonë. Ne jemi në pritje të pagave të plota sot. Menaxhmenti duhet t'i kryejë detyrat e tyre", thuhet në reagim.

Komisioni për Mjedis do ta vizitojë Deçanin për t'i parë shqetësimet e qytetarëve për ndërtimin e hidrocentralit

PRISHTINË, 8 TETOR - Komisioni për Mjedis, Ushqim, Bujqësi, Planifikim dhe Zhvillim, kryesuar nga kryetarja Fitore Pacolli-Dalipi, ka mbajtur mbledhjen e radhës, në të cilën është shqyrtuar draft-

plani i punës për sesionin vjeshtor 2024. Anëtarët e Komisionit shqyrtuan dhe më pas e miratuan planin e punës për sesionin vjeshtor 2024. Komisioni, në kuadër të mbikëqyrjes së Ligjit për

ujërat, u pajtua që të bëjë një vizitë në Lumbardh të Deçanit, për t'i parë nga afër shqetësimet e qytetarëve lidhur me ndërtimin e hidrocentralit atje, i cili ka shfaqur shumë pakënaqësi nga banorët e asaj ane.



Kurti: Çdo angazhim për zhvillimin e fëmijërisë, është angazhim për zhvillimin e vendit tonë

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHINË, 8 TETOR - Kryeministri Albin Kurti, i shoqëruar nga ministrja e Drejtësisë, Albulena Haxhiu dhe ministrja e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, Arbërie Nagavci, mori pjesë në konferencën e organizuar për publikimin e Raportit të Monitorimit "Karta e Vlerësimit", me titull "Cili është rezultati i përgjithshëm i Kosovës për kujdesin ndaj fëmijëve".

Raporti i cili u publikua nga Koalicioni i OJQ-ve për Mbrojtjen e Fëmijëve (KOMF) ofron të dhëna për gjendjen e të drejtave të fëmijëve dhe jep rekomandime të cilat mbështesin përmirësimin dhe mbrojtjen e tyre në Kosovë.

Fjalën e tij kryeministri Kurti e filloi duke thënë se pyetja jonë e përbashkët duhet të jetë se cili është mjedisi i kujdesit për fëmijët tanë sot, dhe çfarë na paralajmëron ky mjedis për të ardhmen e shoqërisë sonë.

Teksa përmendi nismat e ndërmarrja për fëmijët gjatë këtij

mandati qeverisës, kryeministri tha se duke qenë të vetëdijshëm se ka shumë punë për t'u bërë, "ne parimisht kemi siguruar që të rritet mbështetja për politikën sociale dhe të prezantohen skema të reja, duke krijuar barazi nga mosha e hershme". "Ka tri vjet që kemi prezantuar shtesat për fëmijë nën moshën 16-vjeçare, të cilat i dyfishuam e i trefishuam sivjet dhe njëkohësisht shtesat për nënat lehona. Deri më tani kemi mbi 410 mijë fëmijë dhe afër 60 mijë nëna lehona që po përfitojnë. E si efekt dytësor, rreth 100 mijë gra hapën llogari bankare për herë të parë", tha kryeministri.

Ai shtoi se janë ndarë mbi 100 milionë euro për t'i mbështetur përfituesit e skemave të asistencës sociale, është rritur për 100 % buxheti për mbështetje financiare për strehimoret dhe OJQ-të që ofrojnë shërbime sociale, janë shpërndarë mbi 35 mijë pako ushqimore, mbështetur 20 kuzhina popullore, po subvencionohen faturat e energjisë elektrike për mbi 60 mijë familje, ka nisur Pilotimi i reformës së Skemës së Asistencës



Sociale si dhe përmendi investimet në shëndetësi.

Më tutje, kryeministri shtoi se çdo angazhim për zhvillimin e fëmijërisë nga qeveria dhe zyrtarët e përcëm, nga shoqëria në përgjithësi dhe posaçërisht OJQ-të, nga prindërit, familjarët dhe kujdestarët e tyre, është angazhim

për zhvillimin e vendit tonë e të njerëzimit në përgjithësi.

Në përmbyllje të fjalës së tij, kryeministri falënderoi koalicionin e OJQ-ve për Mbrojtjen e Fëmijëve në Kosovë për mbikëqyrjen e rezultateve në këtë fushë dhe për publikimin e Raportit të Monitorimit "Karta e Vlerësimit".

Gjithashtu, uroi që bashkëpunimi i mirë në mes të institucioneve publike, KOMF dhe shoqërisë civile, të vazhdojë të japë fryte për fëmijët e Kosovës.

Në këtë konferencë e pranishme ishte edhe shefja e Zyrës së UNICEF-it në Kosovë, Veronika Vashchenko.

Sveçla njofton se është hapur pikëkalimi në Merdar për mallrat serbe

PRISHINË, 8 TETOR - Autoritetet e Kosovës e kanë hapur të martën pikëkalimin kufitar me Serbinë në Merdar për kalimin e mallrave nga Serbia, njoftoi ministri i Brendshëm i Kosovës, Xhelal Sveçla. "Bazuar në vlerësimin e situatës së sigurisë nga ana e MPB-së, në pikëkalimin kufitar në Merdar, për mallrat me origjinë nga Serbia do të kalohet nga faza e qarkullimit të kufizuar të mallrave në fazën e qarkullimit të mallrave me kontrollë manuale të sigurisë", tha Sveçla.

Importimi i mallrave serbe rifilloi pas vendimit të Qeverisë së Kosovës një ditë më parë për ta hequr kufizimin ndaj mallrave nga Serbia për këtë pikëkalim kufitar. Sveçla shkroi në "Facebook" të martën se pikëkalimi në Merdar do të jetë i hapur menjëherë për të gjitha mallrat nga Serbia, por ato së pari duhet t'u nënshtrohen kontrolleve manuale të sigurisë deri në funksionalizimin e



skanerëve me rreze X. "Transportuesit e mallrave gjatë kësaj periudhe duhet të kenë parasysh këtë ndryshim dhe ta bëjnë planifikimin e duhur të kohës së nevojshme për

procedurat e reja të kalimit të pikës kufitare", shkroi ai. Qeveria e Kosovës e kishte vendosur kufizimin ndaj importit të mallrave nga Serbia në korrik të vitit 2023 për arsye "sigurie", pasi

tre policë të Kosovës ishin arrestuar nga policia serbe. Megjithatë ata ishin liruar më vonë, vendimi për mallrat serbe kishte mbetur në fuqi. Sveçla theksoi të martën se pikat

tjera kufitare me Serbinë do të hapen për të gjitha mallrat "në momentin kur skanerët me rreze X bëhen funksional në ato pika kufitare".

Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, u kërkoi të hënën ndihmë shteteve të Bashkuara dhe vendeve të Perëndimit në sigurimin e skanerëve në pikat kufitare, në mënyrë që në Kosovë të mos hyjë asgjë prej Serbisë që mund t'ia cenojë sigurinë.

Ai ka thënë se deri në sigurim të skanerëve, në Merdar do të kryhen kontrolle të repta. "Ne duhet të ndërmarrim masa të sigurisë, asnjëherë masa tregtare... ne besojmë që ndryshimi i masës është mëse i mjaftueshëm që pasnesër në CEFTA, dhe të hënën në Proces të Berlinit, të kemi sukses të plotë".

Ai e ka pranuar se masa kufizuese ka pasur efekt në tregti, por këtë fakt e ka përshkruar si "pasojë" dhe jo "qëllim" të qeverisë.

Një delegacion i Ministrisë së Drejtësisë nga Maqedonia po qëndron në Kosovë, temë diskutimi edhe incidenti i Osmanit në aeroport

PRISHINË, 8 TETOR - Anëtarët e Komisionit për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit, kryesuar nga Adnan Rustemi, kryetar, priten në takim një delegacion të Ministrisë së Drejtësisë nga Republika e Maqedonisë së Veriut.

Kryetari Rustemi pasi i falënderoi për vizitën në Kosovë, foli për rolin dhe funksionet e Komisionit për Legjislacion. Gjatë takimit delegacionet shprehën gatishmërinë për shkëmbimin e përvojave si dhe thellimin e bashkëpunimit ndërmjet të dyja vendeve. Po në këtë takim u ngrit si

shqetësim incidenti i presidentes së Kosovës, Vjosa Osmani në Aeroportin e Maqedonisë së Veriut, si dhe nga delegacioni maqedonas u kërkua që të burgosurit shqiptarë, të cilët gjenden në burgjet maqedonase, të transferohen në burgjet e Kosovës.



Gjermania mirëpret heqjen e kufizimit ndaj mallrave të Serbisë në Merdar

PRISHTINË, 8 TETOR - Ambasadori i Gjermanisë në Kosovë, Jorn Rohde, ka thënë se mirëpret vendimin e Qeverisë së Kosovës për ta hequr kufizimin ndaj mallrave të Serbisë në pikën kufitare në Merdar. "Ky është një hap i rëndësishëm drejt zhbllokimit të CEFTA-s. Ne do ta mbështesim Qeverinë e Kosovës për ta garantuar që të plotësohen kërkesat e saj të sigurisë dhe do t'i monitorojmë proceset në pikën kufitare", ka thënë ai në platformën X.

Vetë kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka bërë me dije më herët gjatë ditës së hënë se kufizimi për hyrjen e mallrave prej Serbisë është hequr në pikëkalimin në Merdar. Megjithatë, ai ka kërkuar ndihmën e Shteteve të Bashkuara dhe vendeve të Perëndimit për sigurimin e skanerëve në pikat kufitare, në mënyrë që në Kosovë të mos hyjë asgjë prej Serbisë që mund t'ia cenojë sigurinë.

Ai ka thënë se deri në sigurim të skanerëve, në Merdar do të kryhen kontrole të rrepta. "Ne duhet të ndërmarrim masa të sigurisë, asnjëherë masa tregtare... ne besojmë që ndryshimi i masës është më se i mjaftueshëm që pasnesër në CEFTA, dhe të hënën në Proces të

Berlinit, të kemi sukses të plotë". Ai e ka pranuar se masa kufizuese ka pasur efekt në tregti, por këtë fakt e ka përshkruar si "pasoje" dhe jo "qëllim" të qeverisë.

Qeveria e Kosovës e kishte vendosur ndalesën ndaj importit të mallrave nga Serbia në korrik të vitit 2023 për arsye "sigurie", pasi tre policë të Kosovës ishin arrestuar nga policia serbe. Megjithëse ata ishin liruar më vonë, vendimi për mallrat serbe kishte mbetur në fuqi.

I dërguari i posaçëm i Gjermanisë për Ballkanin Perëndimor, Manuel Sarrazin, ka thënë në fillim të shtatorit se kjo ndalesë bllokoi punën e CEFTA-s dhe se, për shkak të saj, Kosova mund ta rrezikojë pjesëmarrjen në Procesin e Berlinit.

CEFTA synon rritjen e tregtisë së mallrave dhe shërbimeve, eliminimin e barrierave tregtare mes palëve dhe tërheqjen e investimeve. Pjesë e saj janë gjashtë vendet e Ballkanit Perëndimor, plus Moldavia që prej vitit 2006.

Oda Ekonomike Amerikane në Kosovë e ka përshëndetur vendimin e Qeverisë së Kosovës sepse, sipas saj, ndalesa ka pasur ndikim negativ në interesat komerciale të Shteteve të



Bashkuara të Amerikës dhe të Shteteve anëtare të Bashkimit Evropian.

Presidenti i Serbisë, Aleksandër Vuçiq, ka thënë të hënën se pret që autoritetet e Kosovës të "bëjnë më të mirën" për ta parandaluar qarkullimin e lirë të mallrave dhe shërbimeve serbe, pavarësisht prej heqjes së ndalesës për produktet serbe në pikëkalimin kufitar Merdar.

Kryeministri i këtij vendi, Millosh Vuçeviq, ka thënë se mirëpret secilin vendim që, sipas tij, përmirëson jetesën e serbëve në Kosovë.

Në javët e fundit Gjermania ka këmbëngulur se ndalimi i importit të mallrave nga Serbia dëmton Marrëveshjen e Tregtisë së Lirë të Evropës Qendrore (CEFTA) dhe Procesin e Berlinit, një nismë që synon ta ndihmojë

zhvillimin ekonomik të gjashtë vendeve të Ballkanit Perëndimor dhe t'i afrojë ato me Bashkimin Evropian.

Samiti i dhjetë i Procesit të Berlinit mbahet më 14 tetor.

Kosova ka qenë pjesë e Procesit të Berlinit që nga themelimi i tij në vitin 2014, dhe disa nga marrëveshjet e nënshkuara në kuadër të kësaj nisme rajonale janë marrëveshja për njohjen reciproke të letërnjoftimeve, diplomave universitare, kualifikimeve profesionale dhe bashkëpunimit në fushën e transportit, energjisë, ekologjinë, digjitalizimit dhe roamingut.

Kosova është anëtare e CEFTA-s prej vitit 2007, por është e përfaqësuar përmes misionit të OKB-së në vend - UNMIK.

Kurti ka thënë të hënën se pret që në takimin e radhës Kosova do të përfaqësohet me emrin e vet.

Qeveria e Kosovës ka kërkuar edhe në të kaluarën që emri të ndryshohet, ndërsa Gjermania ka ofruar "zgjidhjen" në këmbim të heqjes së ndalesës për importin e mallrave nga Serbia. Sarrazin theksoi se pranë emrit të Kosovës do të kishte një yll, ose një fusnotë, që tregon se statusi i Kosovës nuk është zgjidhur përfundimisht.

Pjesëmarrja e Kosovës në "Expo 2025" dhe investimet japoneze

EPOKA E RE

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 8 TETOR - Zëvendësministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, Liza Gashi, në kuadër të vizitës zyrtare që po zhvillon në Japoni, ka takuar përfaqësues të institucioneve japoneze me të cilët ka diskutuar për mundësitë e bashkëpunimit në fusha kyçe, veçanërisht në fushën e tregtisë, të ekonomisë dhe të investimeve. Ajo ka theksuar rëndësinë e pjesëmarrjes së Kosovës në "Expo 2025", një mundësi për promovimin e vendit në arenën ndërkombëtare dhe një platformë për të krijuar ura të reja të komunikimit e të bashkëpunimit ndërmjet botës së zhvilluar dhe potencialit të saj për zhvillim të qëndrueshëm. Në kuadër të kësaj, zëvendësministria Gashi zhvilloi takime të veçanta me drejtorin



menaxhues të Federatës së Bizneseve në Japoni, Keidanren, Ichiro Hara, presidentin e Organizatës Japoneze për Tregtinë e Jashtme, Jetro, Susumu Kataoka, si dhe me drejtorin e përgjithshëm të Departamentit për Lindjen e Mesme dhe Evropën të Agjencisë

Japoneze për Bashkëpunim Ndërkombëtar, Kei Toyama, JICA. Temë e përbashkët e këtyre takimeve ishte pjesëmarrja e Kosovës në "Expo 2025", si edhe mundësitë e investimeve japoneze në vend. Zëvendësministria Gashi vuri në

pah mundësitë që ofron Kosova për investitorët e huaj, duke theksuar përparësitë dhe potencialin që vendi ofron për zhvillim të biznesit. Ajo theksoi mundësitë e bashkëpunimit në sektorë strategjikë, duke përfshirë teknologjinë, turizmin, energjinë e

ripërtërishme dhe prodhimin industrial.

Zëvendësministria Gashi, po ashtu, i njoftoi bashkëbiseduesit për vlerësimet pozitive që i janë bërë Kosovës nga indekset ndërkombëtare lidhur me cilësinë e demokracisë sonë të re, për nivelin e lirisë civile dhe të drejtave politike, lirinë e shtypit, progresin në sundimin e ligjit, por edhe për progresin ekonomik dhe përparimet e shpejta teknologjike dhe hapjen e Kosovës ndaj inovacioneve digjitale.

Zëvendësministria Gashi i ka ftuar përfaqësuesit e bizneseve japoneze dhe të agjencisë për bashkëpunim ndërkombëtar që ta vizitojnë Kosovën, që t'i shohin nga afër mundësinë e zgjerimit të bashkëpunimit dhe të investimeve në Kosovë, duke e fuqizuar më tej marrëdhënien e shkëlqyeshme që kanë dy vendet tona.

BE-ja shpreson në zhbllokimin e CEFTA-s, pasi Kosova hoqi kufizimin ndaj mallrave serbe

PRISHTINË, 8 TETOR - Bashkimi Evropian (BE) e ka cilësuar të martën "hap të duhur" drejt zhbllokimit të vendimmarrjes në CEFTA vendimin e Kosovës për heqjen e kufizimit ndaj importit të mallrave nga Serbia një ditë më parë.

BE-ja e ka parë si "lajm të mirë" vendimin e Qeverisë së Kosovës me shpresë se, në

këtë mënyrë, është hapur rruga për sukses të samitit të Procesit të Berlinit, i cili zhvillohet javën e ardhshme në Gjermani.

Zëdhënësi i BE-së, Peter Stano, ka rikujtuar rëndësinë që CEFTA-s ka për tregun rajonal dhe ka përsëritur mbështetjen e fuqishme të bllokut për këtë. "BE-ja

mbështet tregtinë e lirë të mallrave në gjithë Ballkanin Perëndimor, në përputhje me rregullat e CEFTA-s. Kjo është kyçe për funksionimin e tregut të përbashkët rajonal dhe pjesë përbërëse e planit për rritje në rajon, dhe të dyja këto sjellin përfitime të dukshme për qytetarët në të gjithë rajonin", tha Stano.



Kaizeri, Cari dhe Mbreti George V: Kushërinjtë në luftë



Mbretëresha Viktoria kishte 42 nipër e mbesa të cilët ishin të shpërndarë në të gjithë Evropën dhe të ngulitur në shumë nga monarkitë e kontinentit. Kjo do të thoshte se Lufta e Parë Botërore në fund, ishte një çështje familjare.

Siç e dinë shumë njerëz që kanë studiuar pemën e tyre familjare, sa më shumë të këqymni pemën tuaj familjare, aq më shumë surpriza ka të ngjarë të zbuloni. Mund të vini re lidhje befasuese midis degëve të largëta të pemës suaj dhe të mësoni mënyrat e papritura se si individët – ndoshta me prejardhje të ndryshme dhe që jetonin në vende të ndryshme – ndanin të njëjtën linjë gjaku.

Një shembull dramatik i kësaj që po themi, është Familja Mbretërore dhe plejada e çuditshme e lidhjeve pas Luftës së Parë Botërore. Britania mund të ishte përfshirë nga ethe të zjarra kundër Gjermanisë, me Rudyard Kipling që paralajmëronte se ‘Huni është te porta’, por ajo që harrohet shpesh është se monarku

britanik në atë kohë, George V, ishte kushëriri i parë i Kaizerit Vilhelm i Gjermanisë. Që të dy ishin nipër të mbretëreshës Viktoria.

Babai i George V, Eduardi VII, ishte djali i madh i Viktorias. Ai ishte bërë mbret pas vdekjes së nënës së tij në vitin 1901, duke sunduar vetëm për nëntë vjet derisa edhe vetë vdiq në vitin 1910, kur George V mori detyrën. Nëna e Xhorxhit, meqë ra fjala, ishte Alexandra e Danimarkës – një fakt domethënës të cilit do t’i rikthehemi.

Kaizeri gjerman, ndërkohë, ishte nipi i mbretëreshës Viktoria nga vajza e saj, e quajtur gjithashtu Viktoria, e cila ishte martuar me Frederikun III të Gjermanisë. Në fakt, lidhjet e Vilhelmit me Familjen Mbretërore Britanike ishin shumë më tepër se një çështje gjenetike. Që fëmijë, ai ishte veshur me veshjet e malësisë për martesën e xhaxhait të tij Bertie (i njohur ndryshe si Eduard VII) me Aleksandrën e Danimarkës. Kur ishte adoleshent, atij iu dha Urdhëri i Garter-it nga

Mbretëresha Viktoria, madje ai do të ishte i pranishëm edhe në shtratin e saj të vdekjes.

Shumë kronistë të kësaj periudhe janë magjepsur nga marrëdhënia e vështirë e Vilhelmit me lidhjet e tij britanike, veçanërisht duke vënë në dukje armiqësinë e tij ndaj xhaxhait Bertie – të cilin Vilhelmi e quante “pallua i vjetër” dhe madje “një Satana”. Sipas fjalëve të historianit David Fromkin, “ana gjysmë gjermane e tij ishte në luftë me anën gjysmë angleze”. Në të vërtetë, ambiciet militariste të Kaizerit në skenën evropiane mund të jenë nxitur pjesërisht nga ajo që Miranda Carter, autore e “Tre Perandorët: Tre kushërinjtë, Tre Perandoritë dhe Rruga drejt Luftës së Parë Botërore”, e quan ‘prekshmëria e tij adoleshente dhe dëshira pothuajse edipale për të mundur britanikët.

Aktori i tretë mbretëror në Luftën e Parë Botërore, Cari Nikolla II i Rusisë, kishte gjithashtu një interes shumë personal në ngjarjet. Ai ishte një tjetër kushëri i parë i George V, nëna e


të cilit, Aleksandra e Danimarkës, ishte motra e nënës së Carit, Dagmar e Danimarkës. Përveçse ishin të lidhur ngushtë, Xhorxhi V dhe Nikolla II ngjanin çuditërisht shumë dhe kishin krijuar një miqësi të fortë në vitet e tyre të rinisë. Lidhjet e Carit me mbretërit britanikë u forcuan më tej kur ai u martua me mbesën e preferuar të Mbretëreshës Viktoria, Princeshën Alikë të Hesse (e cila do të vdiste së bashku me të dhe fëmijët, kur familja e Carit u masakrua nga revolucionarët komunistë në vitin 1918).

Sa i përket Vilhelmit dhe Nikollës – ata ishin gjithashtu të lidhur, duke qenë kushërinj të largët nëpër shtëpitë mbretërore ruse dhe prusiane. Ata komunikuan me telegrame dhe letra përpara Luftës së Parë Botërore, duke e quajtur njëri-tjetrin “Uilli” dhe “Niki” dhe dukeshin gjithnjë e më të shqetësuar për gjasat e konfliktit midis kombeve të tyre. “Që të shmangni një fatkeqësi të tillë siç është një luftë evropiane,” i shkroi Cari Kaizerit në vitin 1914, “unë ju lutem në

emër të miqësisë sonë të vjetër që të bëni ç’të mundeni për të ndaluar aleatët tuaj të shkojnë shumë larg.”

Sigurisht, konflikti shpërtheu. Pak më shumë se një vit pas dasmës së vajzës së Kaizerit, Princeshës Viktoria Louise të Prusisë – një rast i shkëlqyer në të cilin George, Nikolla dhe Vilhelmi ishin së bashku për herë të fundit – kushërinjtë ishin në luftë, me Britaninë dhe Rusinë aleate kundër Gjermanisë.

Masakra e paprecedentë e Luftës së Madhe – e mekanizuar, brutale – hodhi poshtë idenë se lidhjet e ngushta familjare midis familjeve mbretërore do të parandalonin kombet të shkonin në gjakderdhje. Mbretëresha Viktoria ishte konsideruar si gjyshja e Evropës dhe, siç shkruan historiani mbretëror, Theo Aronson, “vështirë se kishte një oborr kontinental që të mos mburrej me të paktën një nga marrëdhëniet e saj”. Por asnjë nga këto nuk kishte vlerë, sepse aleancat e ndryshme të shteteve në fund do t’i dënonin të gjitha me luftë. / bota.al



Veton ZYMBERI, redaktor i sportit

Trajneri i Serbisë: Xhaka është lojtar i madh

CYRRIH, 8 TETOR - Të shtunën, më 12 tetor, në Leskoc do të zhvillohet përballja në mes të Serbisë dhe Zvicrës e cila luhet në kuadër të Ligës së Kombeve. Kjo ndeshje përherë është interesante dhe ngjallë emocione për shkak të futbollistëve shqiptarë që luajnë në kombëtaren helveteke. E për

lojën foli trajneri i Serbisë Dragan Stojković, në një konferencë për medie. Ai e vlerësoi lart kapitenin e kombëtares zvicerane, Granit Xhaka. Stojković ka thënë se Xhaka është një lojtar i madh. "Zvicra ka ekip solid. Ka kontinuitet dhe është kompakte. I ka të gjitha që një

ekip duhet t'i ketë. Ka lojtarë kualitativë. Xhaka është lojtar i madh dhe prej tij varet shumë loja e Zvicrës", ka thënë Stojković. "Piksi" foli edhe rreth incidenteve të mundshme gjatë kësaj ndeshje. "Besoj se njerëzit e dinë të kaluarën dhe provokimet. Apeloj që ndeshja të jetë korrekte. Sjelljet në

tribuna të tifozëve të jenë në nivel të lartë. Ato gjëra duhet të harrohen dhe të fokusohemi në futboll. Nuk frikësohem. Kjo është absolutisht absurde. Xhaka është lojtar i madh dhe e di këtë. Vërtet e çmoj. Për shumë vjet shfaq nivel botëror. Mendoj se nuk do të ketë ndonjë problem", deklaroi ai.



Hadari, pas Pejës, i thotë lamtumirë edhe Kosovës

EPOKA E RE Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 8 TETOR - Vetëm një ditë pasi u zyrtarizua largimi i Rami Hadarit nga KB Peja, vjen konfirmimi edhe për largim nga Përfaqësuesja e Kosovës në basketboll. Hadari e kishte marrë drejtimin e "dardanëve" në maj të vitit 2023, derisa të martën Federata e Basketbollit e Kosovës ka njoftuar për dorëheqjen e tij.

"Rami Hadar ka dhënë dorëheqje për arsye personale si përzgjedhës i Kosovës A te meshkujt. Bordi i Federatës së Basketbollit të Kosovës (FBK) ka pranuar dorëheqjen e tij. Hadar ka falënderuar të gjithë për bashkëpunimin, duke u



dëshiruar suksese në të ardhmen. FBK-ja falënderon trajnerin Rami Hadar për angazhimin e tij dhe i dëshiron

suksese në karrierë", thuhet në njoftimin e Federatës së Basketbollit. Hadar e udhëhoqi Kosovën në

parakualifikimet e "Eurobasket 2025", në përballjet me Zvicrën dhe Danimarkën, duke pasur dy fitore dhe dy humbje. Kosova shënoi dy fitore ndaj Zvicrës, si dhe pësoi nga Danimarka. Hadari gjithashtu ishte trajner i Kosovës në dy ndeshjet parakualifikuese për Kupën e Botës 2027, ku Kosova fitoi ndaj Irlandës dhe pësoi nga Azerbajxhani.

Shtëpia e basketbollit e Kosovës ka njoftuar për fillimin e bisedimeve me trajnerë potencialë për t'i udhëhequr "dardanët", ku përzgjedhësi i ri pritet të emërohet shumë shpejt. Ndeshjet e ardhshme për Kosovën janë në muajin nëntor, kundër Zvicrës dhe Irlandës për

parakualifikimet e Kupës së Botës 2027.

Pas ndeshjes kundër Yllit ishte pritur që Hadar do të largohet nga të dyja postet që i mbante, pasi ishte shprehur i revoltuar edhe me FBK-në. "Nuk dua të flas për rrjedhën e lojës. Gjyqtarët vijnë me mision në ndeshje. Nuk e di pse Federata nuk e ka dërguar asnjë gjyqtar me përvojë në këtë ndeshje. Ndaj meje personalisht ka tendencë që tri vjet. As vërejtje nuk më japin para teknikes. Unë më nuk do të hesht. Ju njerëzit në Kosovë duhet të zgjoheni nga gjumi dhe ta shihni realitetin. E marr përgjegjësinë e humbjes. Nuk e di edhe sa do të qëndroj këtu, por ky është realiteti", kishte deklaruar Hadar.

Zeneli: Nuk ka të bëjë asgjë me numrin 10

PRISHTINË, 8 TETOR - Sulmuesi Arbër Zeneli ka reaguar lidhur me situatën e mjegulluar te Përfaqësuesja e Kosovës. Zeneli ka disa ndeshje që nuk po ftohet në listën e parë të Kosovës, por vetëm në atë rezervë, duke ngritur shumë debate. Situatën e tij e ka sqaruar disa herë babai i tij, Avni, i cili ka thënë se sulmuesi pati hatërmetje për marrjen e fanellës me numër 10. Futbollisti Arbër ka reaguar në "Instagram" duke thënë se kjo nuk është arsyeja, por e vërteta qëndron diku tjetër. "Për dardanët! Po flitet shumë tash në media për situatën time me kombëtaren. Nuk kam pasur dëshirë kurrë të flas keq për kombëtaren ose të qesë poshtë kombëtaren. Unë për Kosovë kam luajtur me zemër. Shumë situata janë duke u ekzagjeruar. Për



shembull, numri 10. Nuk ka asgjë të bëjë me numrin si numër 10, por ka të bëjë me situatën që ndodhi me ndeshjen kundër Rumanisë. Unë jam shumë i lumtur që kam luajtur për Kosovën dhe i kam do kujtime që nuk do t'i harroj kurrë.

Faleminderit gjithmonë për mbështetjen prej juve fansave! Kombëtares i dëshiroj gjithmonë shumë sukses në ndeshjet që vijnë. PS. Zgjidhni do ekspertë më të mirë se veç po shtyhen kush po e ka zërin më të lartë", ka shkruar Zeneli.

Trepça sonte e zhvillon ndeshjen e parë në FIBA Europe Cup

MITROVICË, 8 SHTATOR - Rrugëtimi i Trepçës në këtë edicion të FIBA Europe Cup fillon të mërkurën. Mitrovicasit ndodhen në Grupin H. Ata do të kenë përballje mjaft të forta. Në këtë grup garojnë MHP Riesen Ludwigsburg e Gjermanisë, JDA Bourgogne Dijon i Francës dhe Caledonia Gladiators e Skocisë. Kampionët e Kosovës ndeshjen e parë do ta kenë ndaj JDA Bourgogne Dijon, që zhvillohet të mërkurën (sot) nga ora 20:00. Më pas do të kenë tri ndeshje si vendas: MHP Riesen Ludwigsburg më 16 tetor, Caledonia Gladiators 23 tetor dhe JDA Bourgogne Dijon më 30 tetor. Më 5 nëntor do të ndeshen me MHP Riesen Ludwigsburg dhe takimi i fundit është kundër



Caledonia Gladiators më 13 nëntor.

Ky është edicioni i dytë radhazi që kampionët e Kosovës do të marrin pjesë në grupet e FIBA Europe Cup.

Kosova dhe Shqipëria bashkë për CEV U16 Eurovolley 2025

PRISHTINË, 8 TETOR - Një superlajm për sportin tonë! Nga 2 deri më 13 korrik 2025, Kosova dhe Shqipëria do ta organizojnë bashkërisht Kampionatin Evropian CEV

U16 për Femra! Me pjesëmarrjen e 27 shteteve nga e gjithë Evropa, ky kampionat do t'i sjellë emocionet e ndeshjeve më të mira të volejbollit në Prishtinë dhe

Tiranë. "CEV ia ka besuar këtë organizim të madh Federatës së Volejbollit të Kosovës dhe Federatës Shqiptare të Volejbollit (FSHV). Ky është një moment historik për të dyja

vendet tona, duke e treguar fuqinë e bashkëpunimit në sport! Përgatituni për një verë spektakolare të volejbollit më 2025!", ka njoftuar Federata e Volejbollit e Kosovës.



Ademi: Fusha në 'Fadil Vokrri', gati për ndeshjen me Qipron

PRISHTINË, 8 TETOR - Kryetari i Federatës së Futbollit të Kosovës, Agim Ademi, ka bërë me dije se fusha në stadiumin "Fadil Vokrri" është e gatshme për ndeshjen e radhës në Ligën e Kombeve ndërmjet

Kosovës dhe Qipros. Stadiumi ishte mbyllur pasi kishte nevojë për rikuperim të barit pasi ishte dëmtuar nga ndeshjet e muajit shtator. "Sot vizitova fushën e stadiumit 'Fadil Vokrri' së bashku me

ekspertin e ndërtimit dhe mirëmbajtjes së fushës. Tani ajo është në gjendje të mirë dhe mund të jemi të qetë për ndeshjet e radhës të U21, Kosova - Polonia, që luhet të premten dhe për ndeshjen e

Ligës së Kombeve, Kosova - Qipro, që zhvillohet javën e ardhshme. Pas këtyre ndeshjeve, fusha do të kalojë në rikuperim që të jetë gati për sfidat e ardhshme", ka thënë Ademi.



Kelmendi: Kam genë e izoluar dhe kam pasur pak kontakte me njerëz

PRISHTINË, 8 TETOR - Ish-xhudistja, tani trajnere në këtë sport, Majlinda Kelmendi, në një intervistë për TËVËI ka rrëfyer vështirësitë me të cilat ajo është përballur gjatë kohës sa ishte aktive në xhudo. Fillimisht ajo ka thënë se shkaku i përkushtimit të saj ka munguar pothuajse në shumicën e datave të rëndësishme në familjen e saj, siç përmend ditëlindjen e babait dhe të nënës. "Nuk kam shkuar në asnjë dasmë apo fejesë. Babai i ka 71 vjet, ndërsa nëna gati 70 dhe unë kam munguar në këto vitet e fundit në pjesën më të madhe të ditëlindjeve të tyre". "Kam dalë shumë pak, madje as në restorant nuk kam shkuar. Njerëzit kanë pasur shumë pritshmëri prej Majlindës dhe unë këtë e kam ditur. Kam sakrifikuar shumë gjatë karrierës, kam pasur një karrierë 22-vjeçare, sidomos ato 15 të fundit kanë qenë shumë intensive", ka thënë fillimisht Kelmendi.



Tutje, ish-kampionia olimpikë thotë se shpeshherë përballet me pyetjet e njerëzve se si ajo i refuzoi milionat vetëm e vetëm për ta përfaqësuar Kosovën, teksa flet për ofertën që kishte nga Kazakistani. "Edhe sot njerëzit vazhdojnë të më pyesin se si i kam refuzuar milionat. Mënyra se si më shohin njerëzit, as nuk blihet e as nuk shitet". "Derisa je garues gjithmonë duhet ta kesh parasysh se mund t'ju vijnë lëndimet, janë pjesë e rugëtimit dhe, ndoshta, vijnë në momentin më të keq për

ty, nuk i pret asnjëherë", u shpreh ajo. "Nuk e di si do të isha ndier ose a do t'ia kisha falur vetes nëse do të kisha shkuar në vitin 2015 në Kazakistan dhe do ta kisha marrë medaljen e artë olimpikë për Kazakistanin. Gjatë gjithë karrierës sime kam qenë shumë e izoluar dhe kam pasur shumë pak kontakte me njerëz. Kontakti me ta gjithmonë ka qenë nëpërmjet Tonit (Driton Kukës)", ka përfunduar Majlinda Kelmendi.

Iniesta 'var këpucët': Lot emocioni dhe krenarie, s'e kisha menduar kurrë

BARCELONË, 8 TETOR - Një konferencë shtypi, në një ditë shumë simbolike (8 tetor, për të kujtuar numrin që e shoqëroi pothuajse gjatë gjithë karrierës së tij), në vendlindjen e tij, në Barcelonë, i rrethuar nga dashuria e njerëzve që e donin dhe me gjithë familjen e tij të pranishme, Andres Iniesta vendosi ta shpallë zyrtarisht tërheqjen nga futbolli profesionist. "Doja t'i falënderoja të gjithë ata që më shoqëruan sot dhe të gjithë ata që nuk arritën të vinin në këtë ditë të veçantë. Do të më lejon të emocionohem sot, nuk do ta kisha menduar kurrë... (shpërthen në lot). Nuk do ta kisha menduar kurrë se do të kishte ardhur kjo ditë, të gjithë këta lot, që kemi derdhur në ditët e fundit, janë lot emocioni dhe krenarie, janë lotët e atij djalit nga Fuentealbilla, që pas shumë sakrificash, nuk u dorëzua kurrë...", ka thënë Iniesta. "Këto vlera kanë qenë thelbësore në



jetën time, prandaj sot ndihem shumë krenar për gjithë këtë rrugëtim. Arrita ëndrrën time për t'u bërë një futbollist profesionist. Ishte ajo që doja për më tepër", ka shtuar Iniesta. Karriera e ish-mesfushorit ka qenë vërtet e jashtëzakonshme. Me fanellën e Barcelonës hyri në historinë e futbollit, duke fituar gjithçka: 4 Liga të Kampionëve, 3

Botërorë për Klube, 9 kampionate, 3 Superkupa Evropiane, 6 Kupa të Mbretit dhe 7 Superkupa Spanjolle, duke u bërë një nga futbollistët më të rëndësishëm në histori. Me Spanjën ai fitoi dy Evropianë (2008 dhe 2012) dhe një Botëror, me golin vendimtar në finale kundër Holandës që e bëri përfundimisht një legjendë të sportit.

SHKURT

Tare: Immobile, blerja ime më e mirë

Igli Tare, ish-drejtori teknik i ekipit të Lazios, në një konferencë në Palermo, foli për përvojën e vet gjatë 15 viteve të karrierës te klubi kryeqytetas. "Ruaj kujtime shumë të bukura te Lazio, edhe si lojtar, edhe si drejtues për 15 vjet. Mbaj mend që lojtari i parë që kemi blerë atëkohë ka qenë Christian Brocchi. Përse u largova nga Lazio? Nuk kishte asnjë arsye tjetër, veçse fakti që cikli im te ky klub kishte ardhur drejt fundit", ka thënë Tare. Më pas, Tare foli edhe për blerjen më të bujshme të tij, për të cilën ish-sulmuesit të kombëtares kuqezi nuk iu desh shumë kohë për t'u përgjigjur: "Immobile, pas rezultoi se ai ishte sulmuesi më i mirë italian i 20 viteve të fundit. E ardhmja ime? Pres vetëm klubin e duhur në mënyrë që të rikthehem".

Trajneri i Sivassporit: Manaj do të mungojë gjatë

Trajneri i Sivassporit, Bulent Uygun, ka bërë me dije se mungesa e Rey Manajt do të jetë për një kohë të gjatë, çka do të thotë se sulmuesi kuqezi nuk do të mund të japë kontribut as për ndeshjet e muajit nëntor në Ligën e Kombeve.

"Rey Manaj nuk do të jetë në mesin tonë për një kohë të gjatë për shkak të dëmtimit. Është vërtet shqetësuese për ne që edhe Koita është dëmtuar dhe ka hyrë në një periudhë ku nuk e dimë se çfarë do të ndodhë", ka thënë trajneri i Sivassporit. "Ne do ta shfrytëzojmë sa më mirë pushimin për shkak të ndeshjeve të kombëtareve dhe do t'i kompensojmë mangësitë tona në përputhje me rrethanat", ka shtuar ai. Sipas të gjitha gjasave, Sylvinho duhet t'i bëjë llogaritë pas Manajt për ndeshjet e nëntorit.

Usyk, Furyt: Ti je vërtet i lezetshëm, miku im

Boksieri ukrainas Oleksandr Usyk ka replikuar me rivalin e tij britanik Tyson Fury. Ky i fundit komentoi pak ditë më parë për revanshin e dhjetorit, duke thënë se ukrainasi do ta ndiente zemërimin e tij në duelin e tyre të ardhshëm. Usyk mundi "Gypsy King" me vendim shumicë në maj për t'u bërë kampion i padiskutueshëm i botës në peshën e rëndë. Revanshi është planifikuar për 21 dhjetor në Riad të Arabisë Saudite. Ukrainasi në një postim "Instagram" iu përgjigj Furyt. "Ti je vërtet i lezetshëm, miku im", koment shoqëruar edhe me një foto të britanikut që ka pësuar një grusht nga Usyk gjatë duelit të zhvilluar në maj. "Nga sfida me Tyson Furyn mësova shumë për të, shumë gjëra që pashë në luftë nuk i kisha parë në TV apo në zënkat që kishim pasur. Kështu do të përgatitemi edhe më mirë", u shpreh Usyk.

"Dhe, në dashtë Zoti, do ta tregojmë sërish formën tonë më të mirë. Kam një motivim të jashtëzakonshëm. Më thonë shpesh se kam bërë gjithçka, por ne thjesht punojmë çdo ditë. Çdo ditë është një ditë e re", ka deklaruar Usyk.

Shefi i Mercedesit: Kam kohë që s'flirtoj me Verstappenin, kemi besim te pilotët tanë

U desh pak kohë, por Mercedesi më në fund ka gjetur rrugën e tij në të ardhmen e afërt të Formula 1. Pas muajsh negociatash, thashethemesh dhe mosmarrëveshesh, zgjedhja e Toto Wolff ka qenë ajo për ta zëvendësuar Lewis Hamiltonin me Kimi Antonelli. Ai do të jetë

shok skuadre me George Russell. Një vendim i cili i dha fund, të paktën për momentin, spekulimeve për ardhjen e mundshme të Max Verstappenit. Toto Wolff ishte përpjekur vazhdimisht ta bindte holandezin të vinte te Mercedesi. "Tashmë kemi bërë

zgjedhjen tonë edhe pse me Max kishim një vizion të ngjashëm", ka thënë Wolff. "U bë kohë që nuk flirtojmë më me Verstappenin. Ne kemi besim të dy pilotët tanë për të ardhmen. George kishte një trajektore të ngjashme me atë të Kimi për sa i përket kartingut dhe garave në

kategoritë e vogla. Ai ishte i riu i parë që iu bashkua Mercedesit dhe është ende piloti ynë", ka deklaruar Toto Wolff. "Ne nuk do të bëjmë dallim mes tij dhe Antonellit. Të dy do të kenë të njëjtën mbështetje. Çdo pilot në Formula 1 e di se duhet të konkurrojë me shokun e

skuadrës, qoftë i ri apo i vjetër. Për tre vjet, shoku i skuadrës së Georges ishte Hamiltoni, piloti më i madh i të gjitha kohëve. Kështu që ai do të jetë rehat duke konkurruar me një nga më të rinjtë, i cili vjen me pritshmëri të mëdha", ka përfunduar shefi i Mercedesit.



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstva Životne Sredine Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment Spatial Planning and Infrastructure

NJOFTIM PUBLIK

Në Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, Departamentin e Planifikimit Hapësinor, Ndërtim dhe Banim është dorëzuar kërkesë për Kushte Ndërtimore nga United Energy Sh.P.K. Rahovec me Aplikues: Laurat Krasniqi me nr. të protokolit 4329/24 të datës 01.07.2024 për parcelat kadastrale ku planifikohet të ndërtohet parku solar fotovoltaik dhe infrastruktura përcjellëse dhe ndodhen të gjitha në Zonën Kadastrale Zoqishtë dhe Opterushë, me numër të parcelave:

Zona kadastrale Zoqishtë janë: P-71510032-00005-0 ZK; P-71510032-00001-0 dhe Zona Kadastrale Opterushë P-71510056-00001-0, P-71510056-00010-0, P-71510056-00011-0, P-71510056-00012-0, P-71510056-00023-0 me sipërfaqe totale prej 1,720,790 m² që ndodhen në Komunën e Rahovecit.

Kërkesa përcakton kriteret për ndërtimin e Impianti fotovoltaik "Parku Solar United Energy" për gjenerimin e energjisë elektrike bazuar në burim të ripërtëritshëm të energjisë, energji diellore.


Komentet lidhur me këtë propozim duhet të dorëzohen deri më dt. 21.10.2024 në: dkp.mmph@rks-gov.net.

Dokumentet e publikuara:

Kushtet Ndërtimore të propozuara: United Energy Sh.P.K. Zoqishtë dhe Opterushë, Rahovec

Situacioni i gjere dhe i ngushtë sipas projektit konceptual (format A.0) që përmban informatat në vijim:

a. Destinimi aktual apo i propozuar i shfrytëzimit të tokës: Mal i klasës 4,5 dhe 6 Shfrytëzim i përkrahshëm- Prodhim i Energjisë së Ripërtëritshme nga Dielli	
b. Vija irregulhese.	- m'
c. Vija e ndërtimit.	10 m
d. Lartësia e lejuar në proporcion me distancën nga kufijtë e parcelës kadastrale përgjatë rrugës publike	3.5 m
e. Lartësia e lejuar në proporcion me distancën nga kufijtë anësor te parcelës.	3.5 m
f. Përqindja e sipërfaqes ndërtuese bruto në proporcion me sipërfaqen e parcelës kadastrale. Anash të riformulohet sipas kërkesës për kushte	0.65 %
g. Përqindja e sipërfaqes së gjelbëruar bruto në proporcion me sipërfaqen e parcelës kadastrale.	96.79 %
h. Përqindja e sipërfaqes bruto bannese në proporcion me sipërfaqen e parcelës kadastrale.	- %
i. Përqindja e sipërfaqes së përdorshme nëntokësore në proporcion me sipërfaqen e parcelës kadastrale.	- %
j. Numri i hapësirave për vendparkime të automjeteve.	20
k. Materialet në sipërfaqet e jashtme të ndërtesave të reja:	Montuese
l. A ka qasje të pakufizuar në rrugë publike dhe infrastrukturë publike? Po <input checked="" type="checkbox"/> Jo <input type="checkbox"/> Nuk aplikohet <input type="checkbox"/>	
m. Shfrytëzimi i propozuar a do të gjenerojë ndotje të mjedisit apo zhurmë më të madhe se sa zona përreth? Po <input type="checkbox"/> Jo <input checked="" type="checkbox"/> Nuk aplikohet <input type="checkbox"/> Sqaro:	
n. A është ndonjë nga punët ndërtimore në Zona të Mbrojtura, Zona të Veçanta, ose Zona të Veçanta të Mbrojtura? Po <input type="checkbox"/> Jo <input checked="" type="checkbox"/> Nuk aplikohet <input type="checkbox"/> Sqaro:	



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook

www.facebook.com/gjejpuneshpejte

RESTAURANT

SWISS TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

PRISHTINË

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Egzon Krasniqi nga Juniku shpall të pavlefshme diplomën e Gjimnazit "Kuvendi i Juniku" Junik.

- Sylejman Sejda shpall te pavlefshme diplomën Q.K "11 Marsi" Prizren.

- Arzu Bulut shpall te pavlefshme diplomën Q.K "11 Marsi" Prizren.

- Dimal Kabashi shpall te pavlefshme dëftesat e kl VI - IX shfmu "Dëshmorët e Hasit" Kabash, Has.

- Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollëshme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm.

- Për informata më të hollëshme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti,

banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

- Lëshoj banesën e re me qera në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 Euro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)

- Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë nume të tel: 049-440-466.

- Lëshoj banesën një dhomshe me qira , ne lagjen Dardania afër Postës Kryesore (posta e Madhe) Kroj i Bardhe, banesa është e mobiluar tërësisht. Për informata lajmërohuni në tel: 044/558-894 Prishtinë.

- Lëshoj me qira banesën e mobiluar te salloni i mobileve "ALBED" në Fushë Kosovë. Banesa i ka 65 metra katrorë dhe është e gatshme për banim. Më shumë informata në: 044/706-079.

Komuna e Gjakovës
Opština Gjakovica Gjakova Municipality
N.P.L. "STACIONI I AUTOBUSËVE" SH.A.
GJAKOVË
Nr.: 403
Data: 08.10.2024

**N.P.L. "STACIONI I AUTOBUSËVE" SH.A.
GJAKOVË**

KE: 0390/320 010
E-mail: nplbagj@gmail.com
Info: 0390/324 268
Web:

SUI: 811444900
Nr. TVSH: 330311853
BEK: 140200001784638

Në mbështetje të nenit 8 të Ligjit të punës nr.03/L-212, të Republikës së Kosovës, nenit 5 dhe 7 të Udhëzimit Administrativ MFPT – Nr.01/2024 për Regullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik, nenit 3 të Rregullores nr.167 të datës 06.05.2016 mbi Mardhënien në Punë të Punëtorëve, nenit 15 pika 5, 16 dhe 19 të Rregullores Nr.121 të datës 04.04.2016 për Organizimin e Brendshëm, Caktimin e Pozitave, Detyrave dhe Përgjegjësi të Stafit Punës dhe vendimit me Nr.Protokolli 402 të datës 08.10.2024 të U.D. Kryeshefit Ekzekutiv, N.P.L."Stacioni i Autobusëve"SH.A.,Gjakovë, shpallë këtë:

**KONKURS
PËR PLOTËSIMIN E VENDEVE TË LIRA TË PUNËS**

I.Pozita e punës: Manipulant/e

Numri i pozitave: 1 (një)

Kohëzgjatja e punës: 1 (një) vit me mundësi vazhdimi

Detyrat dhe përgjegjësit:

Detyrat e punës:

- Ngarkohet me manipulimin qëndror me dokumentacionin mbi të cilin lëshon reversin me nënshkrim të lexushëm;
- Përsosisht është përgjegjës për dhëjen në rregullsi të bllokave të biletave dhe për saktësin dhe gjendjen e manipulimit;
- Në bazë të qarkullimit të bllokave rezerv, i propozon shefit të kontabilitetit furnizimin e saktë me dokumentacion dhe ngarkes shtesë të vijës së bllokave;
- Është i obliguar që me rastin e marrjes së bllokave të biletave të verifikoi rregullsinë, numrat e serive, numrat e biletave të disa bllokave dhe të mbaj përgjegjësi për këto;
- Kryen edhe punët dhe detyra tjera të përcaktuara nga ZKFTH;

Kushtet:

- Kualifikimi shkolla e mesme
- Përgaditje mesme së paku 2(dy) vite përvojë pune,
- Shkathtësi në punë dhe njohja e punës me programe kompjuterike.

Dokumentacioni i kërkuar:

- CV-në;
- Dëshminë e Kualifikimit Profesional dhe të përvojës së punës
- Kopjen e Letërnjoftimit
- Dëshminë se nuk jeni nën hetime, jo më të vjetër se 3 muaj.

II.Pozita: Laurist / Porter

Numri i pozitave: 1 (një)

Kohëzgjatja e punës: 1 (një) vit me mundësi vazhdimi

Detyrat dhe përgjegjësit:

- Regjistron hyrje-daljet e autobusëve dhe mban evidence për emrin e firmës, relacionin dhe kohën e nisjes;
- Verifikon operatorët me rastin e lëshuarjes së objektit se, a i kanë në rregull fletëleshimet- biletën e paguar të peronizimit për relacionin në fjalë dhe në librin e posaqem të evidencës regjistrojnë kohën e daljes;
- Për punën e tij i përgjigjet Udhëheqësit të Stacionit.

Kualifikimet

- Përgaditje mesme shkollore;
- 1 (një) vit përvojë pune e domosdoshme;
- Të jetë i aftë për punë me presion dhe të ketë shkathtësi në kordinimin e punëve rutinore;
- Të jetë komunikues dhe të njoh ndonjë gjuhë të huaj;
- Njohja e punës me programe kompjuterike përparësi;

Dokumentacioni i kërkuar:

- CV-në;
- Dëshminë e Kualifikimit Profesional dhe të përvojës së punës
- Kopjen e Letërnjoftimit
- Dëshminë se nuk jeni nën hetime, jo më të vjetër se 3 muaj

III. Pozita: Rojtar

Numri i pozitave: 1 (një)

Kohëzgjatja e punës: 1 (një) vit me mundësi vazhdimi

Detyrat dhe përgjegjësit:

- Bën sigurimin e objektit të kompanisë dhe hapsirave përreth;
- Në rast të vërejtjes së rrezikut nga zjarri apo rreziqeve tjera ndërmerr masat më efektive dhe menjëherë kërkon ndihmë për evitimin e të metave;
- Në rast sulmi ndërmerr masa të caktuara konform rregullores mbi punën e shërbimit në sigurimin fiziko – teknik të objekteve;
- Të gjitha të metat e vërejtura i shënon në libër të vërejtjeve dhe mbi të njejtat e informon personin përgjegjës të tij;

- Bën kontrollimin e materialeve, objektit ,automjeteve dhe personave të cilët hyjnë dhe dalin në ndërtesë,njëherit në libër i shënon hyrjet dhe daljet e tjera në kohën kur nuk punohet ose jashtë orarit;
- Nuk lejon daljen e mjeteve në tërësi nga objekti , nëse për këtë nuk posedon një urdhër me shkrim ;
- Bartë uniformën dhe mjetet tjera të lejuara për sigurim,përdorimi i së cilave në mënyrë precize është përcaktuar në rregullat e shërbimit të rojtarëve dhe udhëzimet e udhëheqësit drejtpërdrejtë;
- Shënon kohën e ardhjes dhe daljes së punëtorëve në kohën jashtë orarit të punës;
- Në rastet e vizitës nga ana e udhëheqësit ose personit të autorizuar,ai i raporton mbi gjendjen dhe gjërat e vërejtura gjatë orarit të punës;
- Pranimin dhe dorëzimin e detyrës e bën me shkrim;
- Kryen edhe detyra të tjera, të cilat ia cakton Shefit të Stacionit dhe KE
- Për punën e tij i përgjigjet Shefit të stacionit dhe KE.

Kualifikimet:

- Të kenë të kryer arsimin e mesëm,
- Të kenë së paku 1 vjet përvojë pune përkatëse;
- Të ketë të kryer trajnimin dhe të posedoj certifikaten e zjarrfikësve;

Dokumentacioni i kërkuar:

- CV-në;
- Dëshminë e Kualifikimit Profesional dhe të përvojës së punës
- Kopjen e Lejërmoftimit
- Dëshminë se nuk jeni nën hetime, jo më të vjetër se 3 muaj

Mënyra e aplikimit:

Aplikacioni për punësim tërhiqet në Zyrën e Shërbimit Juridik, kati II, zyra nr.2.

Dorëzimi i aplikacionit bëhet në Zyrën e Shërbimit Juridik, kati II, zyra nr.2 tek Stacioni i Autobusëve në Gjakovë, në pliko të mbyllur, çdo ditë pune, nga ora 08:00 deri në ora 16:00.

Konkursi është i hapur nga data 09.10.2024 deri më 23.10.2024, në ora 16:00.

Kandidatët të cilët konkurojnë duhet ta shënojnë saktë adresën e banimit dhe numrin e telefonit kontaktues, apo dhe e-mail adresën.

Vërejtje: Të cektet qartë titulli i vendit të punës. Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen, ndërsa aplikacionet e mangëta refuzohen.

Gjakovë, më 08.10.2024

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar "G Wraps Prishtina" SH.P.K. me seli në Prishtinë, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nr.b. 812112176 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da društvo sa "G Wraps Prishtina" D.O.O. Pristina, donelo odluku o prestani rada sa nr.b. 812112176 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likfidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavlivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform all customers that the limited liability "G Wraps Prishtina" L.L.C. with headquarters Prishtinë, has come to the decision to quit its business: 812112176 the company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

Kompania Rajonale e Mbeturinave
Regionale Kompanija za Uklanjanje Otpada
"PASTRIMI" sh.a. i.d.d.
Nr. br. 5682 dt. 08.10.2024
Prishtinë - Prishtina



KOMPANIA REGJIONALE E MBETURINAVE "PASTRIMI" SH. A

Duke u bazuar në Ligjin e Punës Nr. 03/L-212, konkretisht Neni 8, në Udhëzimin Administrativ MFPT Nr. 01/2024 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik, konkretisht Neni 5 Paragrafi 1.2 dhe Neni 7, në Rregulloren Nr. 01/2024 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në KRM "Pastrimi" SH. A, në Vendimin e datës 07.10.2024 me numër të protokollit nr. 5653, të Kryeshefit Ekzekutiv të KRM "Pastrimi" SH. A, shpallë këtë:

KONKURS PUBLIK Për plotësimin e vendit të punës

Titulli i vendit të Punës: Zyrtar Ligjor në KRM "Pastrimi" SH. A (1) pozitë;

Departamenti: Drejtoria e Administratës;

Numri i Referencës: DA/KJ-16/2024;

Koeficienti/Paga mujore: Niveli XI;

Kohëzgjatja e Kontratës së Punës: Me kohë të pa caktuar;

Periudha Provuese: 3 muaj;

1. Detyrat dhe Përgjegjësitë:

- Asiston Udhëheqësin e Zyrës Ligjore dhe zyrtarin e lartë ligjor në përpilimin e rregulloreve dhe akteve tjera të kompanisë;
- Përgatit draft shkresa, draft vendime, draft memorandume, draft opinione sipas kërkesave të Udhëheqësit të Zyrës Ligjore dhe zyrtarit të lartë ligjor;
- Kujdeset për përgatitjen, shtypjen e materialeve të mbledhjeve dhe shpërndarjen e tyre;
- Kryen detyra dhe obligime të parapara me akte normative të brendshme;
- Kryen punë dhe detyra tjera që lidhen me përshkrimin e detyrave të punës, të cilat kërkohen nga Udhëheqësi i Zyrës Ligjore;
- Për punën e tij i përgjigjet Përgjegjësit të Zyrës Ligjore.

2. Kriteret e përgjithshme për praninë në detyrë:

- ✓ Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës;
- ✓ Të zotërojë të paktën njërën nga gjuhët zyrtare, në pajtim me Ligjin për Gjuhët;
- ✓ Të jetë e/i aftë për të kryer detyrën përkatëse;
- ✓ Të mos jetë e/i dënuar për kryerjen e një veprës penale;
- ✓ Të ketë arsimin, përvojën e punës profesionale dhe/apo aftësitë e kërkuara për pozitën;
- ✓ Të kalojë me sukses procedurat e pranimit të përcaktuara në këtë ligj.

3. Kërkesat e përgjithshme formale:

- ✓ **Arsimimi i kërkuar:** Diplomë universitare në Fakultetin Juridik;
- ✓ **Përvoja e punës e kërkuar:** 1 vit përvojë pune profesionale.

4. Njohuritë, aftësitë dhe cilësitë e kërkuara në procedurën e rekrutimit:

- ✓ Aftësi të arsyetimit logjik dhe analizës;
- ✓ Aftësi komunikimi dhe ndikim personal, përfshirë aftësi për të përfaqësuar;
- ✓ Shkathtësi hulumtuese, analitike, vlerësuese dhe formulim të rekomandimeve dhe këshillave profesionale;
- ✓ Aftësi për të bërë gjykime profesionale të pavarura dhe për të ushtruar diskrecion mbi çështjet dhe për të dhënë një kontribut të rëndësishëm në zhvillimin dhe zbatimin e politikave;
- ✓ Njohuri të gjera të fushës, së metodave kërkimore, që ndihmojnë në përgatitjen e raporteve bazike dhe analitike.

5. Dokumentet që duhet të dorëzohen si pjesë e aplikimit dhe mënyrën e dorëzimit të tyre:

- ✓ Aplikacioni i plotësuar dhe nënshkruar nga kandidati;
- ✓ Kopje të diplomave të dhëna nga Institucionet Arsimore;
- ✓ Kopje të dëshmisë së punësimit (Trusti Pensional, Vërtetimi, apo Kontratë të Punës);
- ✓ Kopje të dëshmisë së trajnimeve dhe kurseve;
- ✓ Kopje të vlerësimeve të punës për dy vitet e fundit, (e dëshirushme);
- ✓ Kopje të letërnjoftimit;
- ✓ Vërtetimin që nuk është i dënuar për kryerjen e një veprës penale jo më të vjetër se 3 muaj.

6. Mënyra e aplikimit në konkurs:

Kandidatët e interesuar, formularin zyrtar mund ta marrin në Zyrë e Burimeve Njerëzore në KRM "Pastrimi" SH.A.
Të gjitha aplikimet duhet të bëhet vetëm në mënyrë elektronike, nëpërmjet e-mailit: punesimi.krmpastrimi@gmail.com.

7. Data dhe ora e saktë e përmbylljes së Konkursit Publik:

Konkursi publik zgjatë 15 ditë nga data: 09.10.2024 deri me datën 23.10.2024. Koha e fundit e pranimit të aplikimeve është ora 16:00.

Të gjitha aplikimet që arrijnë pas afatit të fundit nuk do të merren parasysh.

8. Mënyra e vlerësimit dhe kriteret e poentimit:

Vlerësimi i kandidatëve bëhet në bazë të CV-së, testit me shkrim dhe me intervistim (test verbal).

- ✓ CV-ja e kandidatit vlerësohet deri në dhjetë (10) pikë;
- ✓ Testi me shkrim vlerësohet deri në shtatëdhjetë (70) pikë;
- ✓ Intervista (testi me gojë) vlerësohet deri në njëzetë (20) pikë.

Procedura e vlerësimit përmban gjithësejt njëqind (100) pikë, ku kalushmëria është arritja e së paku pesëdhjetë e pesë (55) pikëve nga të gjitha fazat e Konkursit Publik.

9. Mënyra e njoftimit dhe komunikimit me kandidatët:

Të gjithë kandidatët do të njoftohen nëpërmjet e-mailit dhe individualisht.

10. Kalendari i përafërt i procedurës së rekrutimit:

Konkursi është i hapur deri me datën 23.10.2024.

Faza e verifikimit paraprak të aplikacioneve deri 7 ditë;

Faza e testit me shkrim deri 10 ditë pas fazës së verifikimit;

Faza e intervistës deri 7 ditë pas shpalljes së rezultateve të testit me shkrim;

Publikimi i rezultateve deri 5 ditë pas vlerësimit të intervistës.

Vërejtje: Dokumentet e pa kompletuara, të pa skanuara si dhe ato që arrijnë pas skadimit të afatit të konkursit nuk do të shqyrtohen.

044 900 978 | 045 687 898

Sallon Depilimi Lume's Details

[lumesdetails](https://www.instagram.com/lumesdetails)

Mbrapa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi

Kompania Rajonale e Mbeturinave
Regionalna Kompanija za Uklanjnje Otrada
"PASTRIMI" sh.a.d.d.
Nr.br. 5682 dt. 08.10.2024
Prishtine - Prishtina



REGIONALNO PREDUZEĆE ZA OTPAD "PASTRIMI" SH. A

Na osnovu Zakona o radu br. 03/L-212, tačnije člana 8, u Upravnoj instrukciji MFPT br. 01/2024 o uređenju konkursnih postupaka u javnom sektoru, odnosno člana 5. stav 1.2 i člana 7., u Uredbi br. 01/2024 o unutrašnjoj organizaciji i sistematizaciji radnih mesta u RPO "Pastrimi" SH.A., u rješenju od 07.10.2024. godine sa brojem postupka br. 5653, izvršni direktor RPO "Pastrimi" SH. A., proglasi:

JAVNI KONKURS Za popunjavanje radnog mesta

Naziv posla: Pravni službenik u RPO "Pastrimi" SH. A. (1) pozicija;

Odeljenje: Direkcija za administraciju;

Referentni broj: DA /JK-16/2024;

Mesečni koeficijent / plata: Nivo XI;

Trajanje ugovora: na neodređeno vreme;

Probni period: 3 meseca;

1. Dužnosti i odgovornosti:

- Pomaže šefu pravne kancelarije i višem pravnom službeniku u izradi propisa i drugih akata kompanije;
- Priprema nacrt radova, predloge odluka, memorandum, predloge mišljenja prema zahtevima rukovodioca Kancelarije i višeg pravnog službenika;
- Brine se o pripremi, štampanju materijala za sastanke i njihovoj distribuciji;
- Obavlja poslove i obaveze propisane internim proaktivnim aktima;
- Obavlja poslove i druge poslove u vezi sa opisom radnih zadataka koje zahteva rukovodilac Pravne kancelarije;
- Za svoj rad mu odgovara šef Pravne kancelarije.

2. Opšti kriterijumi za prijem na dužnost:

- ✓ Da bude državljanin Republike Kosova;
- ✓ Da poseduje najmanje jedan od službenih jezika, u skladu sa Zakonom o jezicima;
- ✓ Biti u stanju da izvrši odgovarajući zadatak;
- ✓ Da ne bude osuđen za izvršenje krivičnog dela;
- ✓ Imaju obrazovanje, profesionalno radno iskustvo i / ili veštine potrebne za poziciju;
- ✓ Uspešno proći procedure prijema utvrđene u ovom zakonu.

3. Opšti formalni zahtevi:

- ✓ **Potrebna stručna sprema:** Visoka stručna sprema na Pravnom fakultetu;
- ✓ **Potrebno radno iskustvo:** 1 godina profesionalnog radnog iskustva .

4. Znanja, veštine i kvalitete potrebne u postupku zapošljavanja:

- ✓ Sposobnost logičkog zaključivanja i analize;
- ✓ Komunikacijske veštine i lični uticaj, uključujući sposobnost predstavljanja;
- ✓ Istraživanje, analitika, evaluacija i formulisanje preporuka i stručnih saveta;
- ✓ Sposobnost donošenja nezavisnih stručnih presuda i ostvarivanja diskrecionog prava o pitanjima i davanja značajnog doprinosa razvoju i sprovođenju politike;
- ✓ Opsežno poznavanje oblasti, istraživačkih metoda, koje pomažu u pripremi osnovnih i analitičkih izveštaja.

5. Dokumenti koji se podnose u okviru prijave i način njihovog podnošenja:

- ✓ Prijava popunjena i potpisana od strane kandidata;
- ✓ Kopije diploma koje dodeljuju obrazovne institucije;
- ✓ Kopija dokaza o zaposlenju (penzioni fond, potvrda ili ugovor o radu);
- ✓ Kopija dokaza o obuci i kursevima;
- ✓ Kopije evaluacija rada za poslednje dve godine (poželjno);
- ✓ Kopija lične karte;
- ✓ Dokaz da nije osuđen za krivično delo, ne starije od 3 meseca.

6. Način prijavljivanja na konkurs:

Zainteresovani kandidati, zvanični obrazac se može dobiti u kancelarijama za ljudske resurse u RPO "Pastrimi" SH.A.
Sve prijave moraju biti podnete samo elektronskim putem, putem e-maila:
punesimi.krPOpastrimi@gmail.com .

7. Tačan datum i vreme zatvaranja javnog konkursa:

Javni konkurs traje 15 dana od: 09.10.2024. do 23.10.2024. godine. Poslednji put prijema aplikacija je 4 sile podne.

Sve prijave koje stignu nakon isteka roka neće se razmatrati.

8. Način vrednovanja i kriterijumi moći:

Evaluacija kandidata vrši se na osnovu biografije, pismenog testa i intervjua (usmeni test).

- ✓ CV kandidata se ocenjuje do deset (10) bodova;
- ✓ Pismeni test se vrednuje do sedamdeset (70) bodova;
- ✓ Intervista (usmeni test) se procenjuje do dvadeset (20) bodova.

Postupak vrednovanja sadrži čitavih stotinu (100) bodova, pri čemu je pecivo ostvarenje najmanje pedeset pet (55) bodova iz svih faza Javnog konkursa.

9. Način obaveštavanja i komunikacije sa kandidatima:

Svi kandidati će biti obavesteni putem e-pošte i pojedinačno.

10. Približan raspored postupka zapošljavanja:

Konkurs je otvoren do 23.10.2024. godine.

Preliminarna faza verifikacije prijava do 7 dana;

Faza pismenog testa do 10 dana nakon faze verifikacije;

Faza intervjua do 7 dana nakon objavljivanja rezultata pismenog testa;

Objavljivanje rezultata do 5 dana nakon evaluacije intervjua.

Napomena: Nesastavljeni, neskenirani dokumenti i oni koji stignu nakon isteka roka za konkurs neće biti pregledani.



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook

www.facebook.com/gjejpuneshejte


RESTAURANT

SWISS

TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

PRISHTINË



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Prishtina - Municipality of Prishtina
SHML GJIMNAZI I Specializuar Matematikor

Gjimnazi I Specializuar Matematikor -Prishtinë
Nr.44/24 , dt.08.10.2024

Duke u bazuar në nenin 11 paragrafi 2 të Udhëzimit Administrativ (MASHT) nr. 02/2016 për aktivitetet jashtëshkollë, SHML "Gjimnazi I Specializuar Matematikor -Prishtinë", shpallë këtë:

FTESË PËR OFERTË

SHML, Gjimnazi I Specializuar Matematikor -në Komunën e Prishtinës organizon ekskursionin e maturantëve të vitit shkollor 2024/2025 për në Republikën e Shqipërisë. Ftohen operatorët ekonomikë për parashtrimin e ofertave përkatëse, duke ju përbajtur kushteve të kësaj oferte.

I. Informata të përgjithshme

1. Ftesa për ofertë mbetet e hapur shtatë (7) ditë nga data e publikimit të ftesës më dt. 08.10.2024 deri më dt. 16.10.2024;
2. Ofertat e operatorëve ekonomikë duhet të përcaktojnë çmimin për nxënës, i cili përfshinë akomodimin në hotel, fjetjen, sigurinë fizike, sigurinë shëndetësore, ushqimin cilësor dhe kalorik, shërbimin mjekësor 24 orë, transportin, shpenzimet përcelëse në monumente dhe vende historike dhe çështje të tjera specifike të kontrollimit teknik dhe personelit të agjencisë të përcaktuara në kushtet e kësaj ftese për ofertë; Datat e përcaktuara (Pesë ditë mes datave 24.10.2024 deri më 28.10.2024).
3. Kohëzgjatja e ekskursionit dhe qëndrimin në Shqipëri do të jetë pesë (5) ditë apo katër (4) bujtje. Në ditën e pestë bëhet kthimi për në Prishtinë;
4. Numri i nxënësve maturantë që do të udhëtojnë për në Republikën e Shqipërisë do të jetë tridhjetë e pesë (35), si edhe personelin e shkollës;
5. Çështje të tjera specifike përcaktohen në kontratën midis autoritetit kontraktues (shkolla) dhe operatorit ekonomik (agjencitë);
6. Operatorët ekonomikë (agjencitë) duhet t'i përbahen të gjitha obligimeve që përcaktohen me Udhëzimin Administrativ (MASHT) nr. 02/2016 për aktivitetet jashtëshkollë dhe të gjitha akteve tjera ligjore/nënligjore përkatëse.

II. Kushtet

1. Operatori ekonomik (agjencia) duhet të ketë lejen e punës;
2. Operatori ekonomik (agjencia) duhet të ketë certifikatën e biznesit dhe informatat përkatëse të biznesit;
3. Operatori ekonomik (agjencia) duhet të ketë vërtetimin tatimor nga ATK;
4. Operatori ekonomik (agjencia) duhet të ketë licencën sipas Ligjit mbi transportin me të drejtë qarkullimi jashtë kufijve të Republikës së Kosovës;
5. Operatori ekonomik (agjencia) duhet të ketë bërë kontrollimin teknik të të gjithë autobusëve sipas procedurave të përcaktuara ligjore;
6. Operatori ekonomik (agjencia) duhet të ketë numër të mjaftueshëm të autobusëve për nevojat e shkollës;
7. Operatori ekonomik (agjencia) duhet të ketë autobusët komfort dhe me klimë;
8. Operatori ekonomik (agjencia) duhet të ketë dokumentacionin (licencën) e agjencisë së akreditimeve të ushqimeve në vendqëndrimin e nxënësve (licenca të jetë e vërtetuar edhe nga pronari i restorantit);
9. Operatori ekonomik (agjencia) duhet të ketë dëshmi për shëndetin psiko-fizik të ngasësve (shoferëve) të autobusëve;
10. Operatori ekonomik (agjencia) duhet të siguron përkujdesje dhe shërbime mjekësore për nxënësit gjatë tërë kohëzgjatjes së ekskursionit, diplomën dhe kontratën e punës së mjekut;
11. Operatori ekonomik (agjencia) duhet të siguron dëshmi për rezervimin e hotelit në datat e caktuara me vërtetim përkatës, i cili hotel duhet të ofron siguri 24 orë për nxënësit dhe personelin përcjellës.
12. Operatori ekonomik (agjencia) duhet të ofron dëshmi se hoteli i rezervuar të posedon licencën për aktivitete të lira dhe argëtim për nxënësit (ballo);
13. Operatori ekonomik (agjencia) duhet të ofron dëshmi se hoteli i rezervuar të mos shërben pije alkoolike;
14. Operatori ekonomik (agjencia) duhet të ofron dëshmi se hoteli i rezervuar ka shtretër të mjaftueshëm për 000 nxënës dhe të mos sistemohen më shumë se tre/katër nxënës në dhomë;
15. Operatori ekonomik (agjencia) duhet të ofron dëshmi se hoteli i rezervuar ka sallën e licencuar të ushqimit dhe ofron tre (3) porcione të plota të ushqimit;
16. Operatori ekonomik (agjencia) duhet të ofron dëshmi se hoteli i rezervuar është i rrethuar dhe krijon siguri për nxënësit;
17. Operatori ekonomik (agjencia) duhet të ofron listën e ngasësve (shoferëve) të autobusëve dhe punëtorëve që do të marrin pjesë në ekskursion;
18. Operatori ekonomik (agjencia) duhet të ofron referime tjera organizative të ekskursioneve me maturantë;
19. Operatori ekonomik (agjencia) duhet të siguron dëshmi të kushteve dhe standardeve me pamje përkatëse të hotelit të rezervuar;
20. Operatori ekonomik (agjencia) duhet të siguron të dhënat e hotelit të rezervuar, emrin dhe mbiemrin e pronarit, adresën dhe numrin kontaktues të pronarit/përgjegjësve të hotelit të rezervuar;
21. Lirimi deri në tre (3) përqind (%) e numrit të pjesëmarrjes së nxënësve në ekskursion me gjendje të vështirë ekonomike, që përcaktohet nga Këshilli organizativ i ekskursionit.

III. Dokumentet e kërkuara

1. Leja e punës së OE;
2. Certifikatën dhe informatat e biznesit së OE;
3. Vërtetimi tatimor nga ATK;
4. Licenca e transportit ndërkombëtar - D të OE;
5. Librezat e të gjithë autobusëve të OE;
6. Dëshmia e kontrollimit teknik të autobusëve;
7. Dëshmi të komfortit/klimës së autobusëve;
8. Licenca e agjencisë së akreditimeve të ushqimeve në vendqëndrimin e nxënësve (vërtetim nga pronari i restorantit/hotelit);
9. Certifikata shëndetësore e ngasësve (shoferëve) të autobusëve;
10. Diploma dhe Kontrata e punës së mjekut;
11. Dëshmia e rezervimit të hotelit - Vërtetim (Verifikohet nga Komisioni)
12. Licenca/vërtetimi i hotelit për aktivitete të lira dhe rekreative për nxënësit;
13. Vërtetimi i hotelit për mos-shërbim të pijeve alkoolike;
14. Vërtetimi i hotelit për numrin e dhomave dhe sistemimin për numrin e nxënësve për dhomë;
15. Licenca e hotelit për sallën e ushqimit në ofrimin e tre vakteve ushqimore;
16. Vërtetimi i hotelit për sigurinë e nxënësve;
17. Lista e ngasësve me licencën D për transport ndërkombëtar;
18. Dëshmi tjera organizative të ekskursioneve përkatëse;
19. Fotografi dhe dëshmi të standardeve dhe kushteve të hotelit të rezervuar;
20. Konfirmim me të dhënat e vendndodhjes së hotelit dhe të dhënat e pronarit të hotelit.
21. Deklarata për lirim nga pagesa deri në tre (3) përqind (%) e numrit të pjesëmarrjes së nxënësve në ekskursion me gjendje të vështirë ekonomike.

V. Dorëzimi i dokumenteve

1. Ftesa për ofertë do të jetë e hapur shtatë (7) dita nga data e publikimit të ftesës për ofertë më 08.10.2024 deri më dt. 16.10.2024;
2. Aplikimi dhe dorëzimi i dokumenteve bëhet në *zarf të mbyllur* në objektin e vjetër të Komunës të Prishtinës me protokoll zyrtar, në sportelin nr. 5, drejtuar Drejtorisë së Arsimit të Komunës të Prishtinës;
3. Dokumentet e dorëzuara nuk kthehen dhe duhet të jenë kopje të noterizuara; Të noterizuara duhet të jenë dokumentet me numër rendor një (1), dy (2), katër (4), dhe gjashtë (6).
4. Aplikacionet e dorëzuara pas afatit nuk pranohen, ndërsa aplikacionet e mangëta refuzohen;
5. Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave të dorëzuara bëhet nga Komisioni përkatës në Drejtorinë e Arsimit, duke respektuar kushtet dhe kriteret e përcaktuara me legjislacionin në fuqi;
6. Ofertuesi i përzgjedhur merr të gjitha obligimet e përcaktuara sipas legjislacionit në fuqi.



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punës
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë

facebook  www.facebook.com/gjejpuneshpejte

RESTAURANT

SWISS

TAVERNA

Tel: +377 45 400 156  +386 49 848 553

PRISHTINË





ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales





TRADITË QË NGA

1992

